15. **"Shkarkim elektrik në gaz"** është proçesi i prodhimit të dritës, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një shkarkesë elektrike përmes një mase gazi, plazme, avujsh metalikë, ose përzierje gazesh dhe avujsh;

16. **"Diodë inorganike që lëshon dritë"** (LED) është teknologjia në të cilën drita prodhohet nga një pajisje në gjendje të ngurtë që ka brenda saj një nyje të llojit p-n me material jo organik. Pika e bashkimit (nyja) lëshon rrezatim optik kur ngacmohet nga një rrymë elektrike;

17. **"Diodë organike që lëshon dritë"** (OLED) është teknologjia në të cilën drita prodhohet nga një pajisje në gjendje të ngurtë që ka brenda saj një nyje të llojit p-n me material organik. Pika e bashkimit (nyja) lëshon rrezatim optik kur ngacmohet nga një rrymë elektrike;

18. **"Burim drite natriumi me presion të lartë"** (HPS) është një burim drite i krijuar nga shkarkesa me intensitet të lartë, në të cilin drita prodhohet kryesisht nga rrezatimi i avullit të natriumit që vepron me një trysni të pjesshme të rendit prej 10 kilo paskal. Burimet e dritës HPS mund të kenë një ("me një skaj") ose dy ("me dy skaje") lidhëse në furnizimin e tyre me energji elektrike;

19. **"pika e shitjes"** është vendndodhja fizike ku produkti shfaqet ose u ofrohet klientëve për shitje, qira ose për pagesë me këste;

20. **"ndriçues nga rrjeti elektrik"** (MLS) është një ndriçues që mund të përdoret drejtpërdrejt në rrjetin e furnizimit me energji elektrike. Ndriçuesit që funksionojnë drejtpërdrejt në rrjet, dhe gjithashtu mund të funksionojnë në mënyrë indirekte në rrjet duke përdorur një pajisje kontrolli të veçantë, do të konsiderohen si ndriçues të rrjetit;
21. **"ndriçues jo nga rrjeti"** (NMLS) është një ndriçues që kërkon një pajisje kontrolli të veçantë për të funksionuar në rrjet;
22. **"pajisja e veçantë kontrolli"** është një pajisje kontrolli që nuk është e integruar fizikisht me një ndriçues dhe është hedhur në treg si një produkt i veçantë ose si pjesë e një produkti të përbërë;
23. **"ndriçues i drejtuar (përqëndruar)"** (DLS) është një ndriçues që ka të paktën 80 % të fluksit total të dritës brenda një këndi konik prej π sr (që korrespondon me një kon me kënd prej 120°);
24. **"ndriçues jo-i drejtuar (përqëndruar)"** (NDLS) është një ndriçues që nuk është një ndriçues i drejtuar;
25. **"ndriçues i lidhur"** (CLS) është një ndriçues që përfshin pjesë lidhëse të të dhënave që janë fizikisht ose funksionalisht të pandashme nga pjesët që lëshojnë dritë, për të

ruajtur "cilësimet e kontrollit të referencës". Ndriçuesi mund të ketë pjesë lidhëse të të dhënave të integruara fizikisht në një fole të vetme të pashkëputshme nga pajisja vetë, ose ndriçuesi mund të kombinohet me pjesë fizikisht të veçanta lidhëse të të dhënave që janë hedhur në treg së bashku me ndriçuesin si një produkt i vetëm;

26. **"Pjesë për lidhjen e të dhënave"** janë pjesët që kryejnë një nga funksionet e mëposhtme:
    a) marrja ose transmetimi i sinjaleve të të dhënave me fije ose pa fije, dhe përpunimin e tyre (përdorur për të kontrolluar funksionin e emetimit të dritës, dhe mundësi të tjera);
    b) kapjen dhe përpunimi i sinjaleve të kapura (përdoret për të kontrolluar funksionin e emetimit të dritës, dhe mundësi të tjera);
    c) një kombinim i sa më sipër;
27. **"ndriçues i rregullueshëm ndaj ngjyrave"** (CTLS) është një ndriçues që mund të përcaktohet që të lëshojë dritë me një larmi të madhe ngjyrash jashtë diapazonit të përcaktuar në nenin 2, por gjithashtu mund të rregullohet që të lëshojë dritë të bardhë brenda diapazonit të përcaktuar në nenin 2, sipas të cilit ndriçuesi është brenda objektit të kësaj rregulloreje. Nuk do të konsiderohen si CTLS ndriçuesit me dritë të bardhë të rregullueshme që mund të përcaktohen që të lëshojnë dritë vetëm me temperatura të ndryshme ngjyrash të ndërlidhura, brenda intervalit të përcaktuar në kreun 2, dhe ndriçuesit me dritë të zbehtë-në-të-ngrohtë që e zhvendosin lëshimin e tyre të dritës së bardhë në temperaturë të ngjyrës përkatëse më të ulët kur zbehet, duke imituar ndriçimin e ndriçuesve inkandeshent;
28. **"pastërti e ngacmimit"** është përqindja e përllogaritur për një grup CTLS që të lëshojë dritë të një ngjyre të caktuar, duke përdorur një procedurë që përcaktohet më tej në standarde, duke hequr një vijë të drejtë në një grafik hapësinor me ngjyra (x dhe y) nga një pikë me koordinata ngjyrash x = 0,333 dhe y = 0,333 (stimul akromatik; pika (1), duke kaluar përmes pikës që përfaqëson koordinatat e ngjyrave (x dhe y) të burimit të dritës (pika (2) dhe duke përfunduar në kufirin e jashtëm të hapësirës së ngjyrave (vendndodhja Pika (3). Pastërtia e ngacmimit llogaritet si distanca ndërmjet pikave 1 dhe 2, pjesëtuar nga distanca midis pikave 1 dhe 3. Gjatësia e plotë e vijës përfaqëson pastërtinë 100% të ngjyrës (pika në vendndodhje). Pika e stimulimit akromatik përfaqëson 0% pastërti të ngjyrës (dritë e bardhë);
29. **"ndriçues me ndriçim të lartë"** (HLLS) është një ndriçues LED me një ndriçim mesatar më të madh se 30 cd/mm^2 në drejtim të intensitetit pik;
30. **"ndritshmëri - ndriçim"** (në një drejtim të caktuar, në një pikë të caktuar të një sipërfaqeje reale ose imagjinare) është fluksi i dritës që transmetohet nga një tufë rrezesh parësore që kalon nëpër pikën e caktuar dhe përhapet në kënd konik, duke ruajtur drejtimin fillestar, pjesëtuar me sipërfaqen e një prerje tërthore të asaj tufe rrezeje që përmban pikën e dhënë (cd/m^2);
31. **"ndriçim mesatar"** (Luminance-HLLS) për një ndriçues LED është ndriçimi mesatar mbi një zonë që lëshon dritë, ku ndriçimi është më shumë se 50 % e ndriçimit maksimal (cd/mm^2);
32. **"pjesët e kontrollit të ndriçimit"** janë pjesët që janë të integruara brenda në një ndriçues, apo veçmas fizikisht, por që tregtohen së bashku me një ndriçues si një produkt i vetëm, të cilat nuk janë medoemos të nevojshme për këto ndriçues që ata të lëshojë dritë në ngarkesë të plotë, por që mundësojnë kontroll manual ose automatik, të

drejtpërdrejtë ose në distancë, të intensitetit të dritës, ngjyrave, temperaturës së ngjyrave përkatëse, spektrit të dritës dhe/ose këndin e tufës së rrezeve. Rregulluesit e dritës, dhe pjesët e lidhjes së të dhënave, gjithashtu do të konsiderohen si pjesë e kontrollit të ndriçimit.

33. **"pjesë jo ndriçuese"** janë pjesët e integruara në një ndriçues, ose të ndara fizikisht, por që tregtohen së bashku me një ndriçues si një produkt i vetëm, që nuk janë të nevojshme që ndriçuesi të lëshojë dritë në ngarkesë të plotë, dhe që nuk janë "pjesët e kontrollit të ndriçimit". Shembujt përfshijnë, por nuk kufizohen në: altoparlantët (audio), kamerat, përsëritësit për sinjalet e komunikimit për të zgjeruar fushën (p.sh. WiFi), pjesë që mbështesin stabilitetin e rrjetit (kalimi në bateritë e veta të brendshme kur është e nevojshme), karikimi i baterisë, njoftimi pamor i ngjarjeve të ndryshme (ardhja e postës, zilja e derës, alarmi), përdorimi i Light Fidelity (Li-Fi, një teknologji komunikimi dy-drejtimëshe pa fije, me shpejtësi të lartë dhe plotësisht të lidhur në rrjet). Termi përfshin gjithashtu pjesë të lidhjes së të dhënave të përdorura për funksione të tjera përveçse për të kontrolluar funksionin e emetimit të dritës;
34. **"fluks i dobishëm ndriçues"** ($\Phi_{\text{përdorimi}}$) është pjesa e fluksit ndriçues të një ndriçuesi që merret parasysh gjatë përcaktimit të efiçencës së tij energjetike:
    a) për burimet jo të drejtuara të dritës, është fluksi total i emetuar në një kënd konik prej 4π sr (që korrespondon me një sferë 360°);
    b) për burimet e drejtuara të dritës me kënd rreze $\geq 90°$, është fluksi i emetuar në një kënd konik π sr (që i korrespondon një koni me kënd 120°);
    c) për burimet e drejtuara të dritës me kënd rreze $< 90°$, është fluksi i emetuar në një kënd konik prej $0{,}586\pi$ sr (që i korrespondon një koni me kënd 90°);
35. **"këndi i tufës së rrezeve"** i një ndriçuesi të drejtuar është këndi midis dy vijave imagjinare në një rrafsh përmes boshtit të rrezes optike, në mënyrë që këto vija të kalojnë përmes qendrës së faqes së përparme të ndriçuesit dhe përmes pikave në të cilat intensiteti i dritës është 50 % e intensitetit të tufës së rrezes qëndrore, ku intensiteti i rrezes qëndrore është vlera e intensitetit të dritës e matur në boshtin e rrezes optike.

    Për ndriçuesit që kanë kënde të ndryshme të rrezeve në plane të ndryshme, këndi më i madh i rrezes do të jetë ai që merret parasysh;
    Për ndriçuesit me kënd të rrezeve të kontrollueshme nga përdoruesi, këndi i rrezes që korrespondon me "setimin (përcaktimin) e kontrollit të referencës" do të jetë ai që merret parasysh;
36. **"ngarkesë e plotë"** është gjendjen e një burimi drite, brenda kushteve të deklaruara të funksionimit, në të cilin ai lëshon fluksin maksimal (të pa errrësuar) të ndriçimit;
37. **"opsioni në gatishmëri (standby)"** është gjendja e një ndriçuesi, ku ai është i lidhur me furnizimin me energji, por ndriçuesi qëllimisht nuk po lëshon dritë dhe është në pritje të një sinjali kontrolli për t'u kthyer në një gjendje me emetim drite. Pjesët e kontrollit të ndriçimit që mundësojnë funksionin e gatishmërisë duhet të jenë në gjendjen e tyre të kontrollit. Pjesët që nuk ndriçojnë duhet të shkëputen ose fiken ose konsumi i tyre i energjisë duhet të minimizohet sipas udhëzimeve të prodhuesit;
38. **"opsioni i gatishmërisë (standby) i rrjetit"** është gjendja e një ndriçuesi të lidhur (CLS), ku është i lidhur me furnizimin me energji, por ndriçuesi qëllimisht nuk lëshon dritë dhe është në pritje të një ndezjeje të nxitur në distancë për t'u kthyer në një

gjendje emetimi drite. Pjesët e kontrollit të ndriçimit duhet të jenë në opsionin e tyre të kontrollit. Pjesët që nuk ndriçojnë duhet të shkëputen ose fiken ose konsumi i tyre i energjisë duhet të minimizohet sipas udhëzimeve të prodhuesit;

39. **"opsioni i kontrollit"** është gjendja e pjesëve të kontrollit të ndriçimit ku ato janë të lidhura me ndriçuesin dhe kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të tillë që një sinjal kontrolli të mund të gjenerohet nga brenda ose të merret një sinjal ndezjeje në distancë (telekomandë), me fije ose valë, dhe që kjo të përpunohet për të sjellë në një ndryshim në emetimin e dritës së ndriçuesit;
40. **"ndezje e krijuar në distancë (telekomandë)"** është një sinjal që vjen nga jashtë ndriçuesit nëpërmjet një rrjeti;
41. **"sinjal kontrolli"** është një sinjal analog ose digjital i transmetuar në ndriçues me valë ose me fije ose nëpërmjet modulimit të tensionit në kabllo të veçanta kontrolli ose nëpërmjet një sinjali të moduluar në tensionin e furnizimit. Transmetimi i sinjalit nuk bëhet nëpërmjet një rrjeti, por p.sh. nga një burim i brendshëm ose nga një telekomandë e dorëzuar me produktin;
42. **"rrjet"** është një infrastrukturë komunikimi me një topologji lidhjesh, një arkitekturë, që përfshin përbërësit fizikë, parimet organizative, procedurat dhe formatet e komunikimit (protokollet);
43. **"fuqi në opsionin e ndezur"** (P_{on}) i shprehur në vat, është konsumi i energjisë elektrike të një ndriçuesi me ngarkesë të plotë me të gjitha pjesët e kontrollit të ndriçimit dhe pjesët jo ndriçuese të shkëputura. Nëse këto pjesë nuk mund të shkëputen, ato duhet të fiken ose konsumi i energjisë prej tyre duhet të minimizohet, sipas udhëzimeve të prodhuesit. Në rast të një NMLS që kërkon një pajisje të veçantë kontrolli për të funksionuar, P_{ON} mund të matet drejtpërdrejt në hyrjen e ndriçuesit, ose P_{ON} përcaktohet duke përdorur një pajisje kontrolli me efiçencë të njohur, konsumi i energjisë elektrike i të cilit më pas zbritet nga vlera e matur e hyrjes së energjisë elektrike;
44. **"fuqia e gatishmërisë (në gjendje standby)"** (P_{sb}) i shprehur në vat, është konsumi i energjisë elektrike të një ndriçuesi në opsionin e gatishmërisë;
45. **"fuqia e gatishmërisë së rrjetit"** (P_{net}) e shprehur në vat, është konsumi i energjisë elektrike të një ndriçuesi të lidhur (CLS) në opsionin e gatishmërisë në rrjet;
46. **"cilësimet e kontrollit të referencës"** (RCS) është një cilësim kontrolli ose një kombinim i cilësimeve të kontrollit që përdoret për të verifikuar përputhjen e një ndriçuesi me këtë rregullore. Këto cilësime janë të rëndësishme për ndriçuesit që lejojnë përdoruesin fundor të kontrollojë, manualisht ose automatikisht, drejtpërdrejt ose në distancë, intensitetin e ndriçimit, ngjyrën, temperaturën e ndërlidhur të ngjyrës, spektrin dhe/ose këndin e rrezes së dritës së emetuar.

    Në parim, cilësimet referencë të kontrollit duhet të jenë të paracaktuara nga prodhuesi si vlera të paracaktuara nga fabrika dhe të hasura nga përdoruesi në instalimin e parë (vlerat jashtë kutisë). Nëse procedura e instalimit parashikon një përditësim automatik të softuerit gjatë instalimit të parë, ose nëse përdoruesi ka opsionin për të kryer një përditësim të tillë, do të merret parasysh ndryshimi që rezulton në cilësimet (apo setime, nëse ka).

    Nëse vlera jashtë kutisë është vendosur qëllimisht ndryshe nga cilësimi (setimi) i

kontrollit të referencës (p.sh. me fuqi të ulët për qëllime sigurie), prodhuesi duhet të tregojë në dokumentacionin teknik se si të ri sjellë parametrat e kontrollit të referencës për verifikimin e pajtueshmërisë dhe të japë një arsyetimi teknik se përse vlera jashtë kutisë është vendosur ndryshe nga cilësimi i kontrollit të referencës.

Prodhuesi i ndriçuesit përcakton parametrat e kontrollit të referencës në mënyrë që:

- ndriçuesi të jetë brenda fushëveprimit të kësaj rregulloreje sipas kreut 1 dhe që të mos jenë duke u zbatuar asnjë nga kushtet për përjashtim;
- pjesët e kontrollit të ndriçimit dhe pjesët jo ndriçuese të jenë shkëputur ose fikur, ose, në rast se kjo nuk është e mundur, konsumi i energjisë i këtyre pjesëve të jetë minimal;
- të jetë arritur gjendja e ngarkesës së plotë;
- kur përdoruesi përfundimtar zgjedh të përcaktojë standardet e fabrikës, ai të arrijë cilësimet e kontrollit të referencës.

Për ndriçuesit që lejojnë prodhuesin e një produkti të përbërë të bëjë zgjedhje zbatimi që ndikojnë në karakteristikat e ndriçuesit (p.sh. përcaktimi i rrymës(ve) funksionuese; dizajni termik) dhe që kjo nuk mund të kontrollohen nga përdoruesi fundor, cilësimet e kontrollit të referencës nuk ka nevojë të përcaktohen. Në atë rast zbatohen kushtet nominale të provës siç përcaktohen nga prodhuesi i ndriçuesit;

47. **"ndriçues me zhivë me presion të lartë"** është një ndriçues me shkarkim me intensitet të lartë, në të cilin pjesa më e madhe e dritës prodhohet drejtpërdrejt ose tërthorazi kryesisht nga rrezatimi i zhivës së avulluar që vepron me një trysni të pjesshme prej 100 kilo paskal;
48. **"ndriçues halidi metalik"** (MH) është një ndriçues i krijuar prej shkarkimit me intensitet të lartë, në të cilin drita prodhohet nga rrezatimi i një përzierje e avullit metalik, halideve metalike dhe produkteve të shpërbërjes së halideve metalike. Ndriçuesit MH mund të kenë një ("me një skaj") ose dy ("me dy skaje") lidhëse në furnizimin e tyre me energji elektrike. Materiali për tubin e harkut të ndriçuesve MH mund të jetë kuarci (QMH) ose qeramika (CMH);
49. **"ndriçues fluoreshent kompakt"** (CFL) është një ndriçues fluoreshent me një kapak të vetëm me një tub të përkulur që është ideuar për t'u përshtatur në hapësira të vogla. CFL-të mund të jenë kryesisht në formë spirale ose kryesisht në formën e tubave të shumtë paralelë të lidhur me njëri tjetrin, me ose pa një shtresë mbështjellëse të dytë në formë llambe. CFL-të janë të disponueshme me (CFLi) ose pa (CFLni) pajisje kontrolli të integruar fizikisht;
50. **"T2", "T5", "T8", "9" dhe "T12"** është një ndriçues tubular me diametër afërsisht 7, 16, 26, 29 dhe 38 mm përkatësisht, siç përcaktohet në standarde. Tubi mund të jetë i drejtë (linear) ose i përkulur (p.sh. në formë U-je, rrethore);
51. **"LFL T5-HE"** është një ndriçues fluoreshent linear T5 me efikasitet të lartë me rrymë lëvizëse më të ulët se 0,2 A;

52. **"LFL T5-HO"** është një ndriçues fluoreshent linear T5 me fuqi të lartë me rrymë lëvizëse më të lartë ose të barabartë me 0,2 A;
53. **"HL R7s"** është një ndriçues halogjen linear nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike, me kapak të dyfishtë, me një diametër mbulesë prej 7 mm;
54. **"funksional me bateri"** është një produkt që funksionon vetëm me rrymë të vazhdueshme (DC) të furnizuar nga një burim i përfshirë në të njëjtin produkt, pa u lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me rrjetin e furnizimit me energji elektrike;
55. **"Mbështjellje e dytë"** është një mbështjellëse e dytë e jashtme në një burim drite HID që nuk nevojitet për prodhimin e dritës, si p.sh. një shtresë e jashtme për parandalimin e derdhjes së zhivës apo të daljes në mjedisin e jashtëm të gazeve nga qelqi, nëse llamba thyhet. Në përcaktimin e pranisë së një shtrese të dytë, tubat HID të qarkut nuk do të llogariten si shtresë;
56. **"shtresë jo e tejdukshme"** për një burim HID drite është një shtresë jo e tejdukshme ose tub të jashtëm në të cilin tubi i harkut që prodhon dritë nuk është i dukshëm;
57. **"mburojë kundër reflektimit të dritës"** është një mburojë mekanike ose optike reflektuese ose jo-reflektuese e papërshkueshme e krijuar për të bllokuar rrezatimin e drejtpërdrejtë të dukshëm të emetuar nga emetuesi i dritës në një ndriçues të drejtuar, në mënyrë që të shmanget verbëria e pjesshme e përkohshme (shkëlqimi i paaftësisë) nëse shikohet drejtpërdrejt nga një vëzhgues. Nuk përfshin veshjen sipërfaqësore të emetuesit të dritës në ndriçuesin e drejtuar;
58. **"dridhje"** është perceptimi i paqëndrueshmërisë vizuale të shkaktuar nga një stimul drite, ndriçimi ose shpërndarja spektrale e të cilit luhatet me kohën, për një vëzhgues statik në një mjedis statik. Luhatjet mund të jenë periodike dhe jo periodike dhe mund të shkaktohen nga vetë ndriçuesi, burimi i energjisë ose faktorë të tjerë ndikues. Njësia matëse për dridhjen e përdorur në këtë rregullore është parametri "Pst LM", ku 'st' do të thotë afatshkurtër dhe "LM" për metodën e dridhjes së dritës, siç përcaktohet në standarde. Një vlerë Pst LM = 1 do të thotë që vëzhguesi mesatar ka një probabilitet prej 50% për të zbuluar dridhje;
59. **"Efekt stroboskopik"** është një ndryshim në perceptimin e lëvizjes i shkaktuar nga një stimul drite, ndriçimi ose shpërndarja spektrale e të cilit luhatet me kohën, për një vëzhgues statik në një mjedis jo statik. Luhatjet mund të jenë periodike dhe jo periodike dhe mund të shkaktohen nga vetë ndriçuesi, burimi i energjisë ose faktorë të tjerë ndikues. Njësia matëse për efektin stroboskopik të përdorur në këtë rregullore është "SVM" (masa e dukshmërisë stroboskopike), siç përcaktohet në standarde. SVM = 1 përfaqëson pragun e dukshmërisë për një vëzhgues mesatar;
60. **"R9"** është indeksi i paraqitjes së ngjyrave për një objekt me ngjyrë të kuqe siç përcaktohet në standarde;
61. **"vlera e deklaruar"** për një parametër është vlera e dhënë nga furnizuesi në dokumentacionin teknik në përputhje me nenin 9 të ligjit nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji";
62. **"Intensiteti i dritës"** (kandela ose cd) është sasia e fluksit ndriçues që largohet nga burimi dhe përhapet në elementin e këndit konik që ka një drejtim të caktuar nga elementi i këndit konik;
63. **"temperatura përkatëse e ngjyrës"** (CCT [K]) është temperatura e një radiatori Planckian (trupi i zi), ngjyra e perceptuar e të cilit ngjan më së shumti me atë të një stimuli të caktuar me të njëjtën shkëlqim dhe në kushte të specifikuara shikimi;

64. **"qëndrueshmëria e ngjyrës"** është devijimi maksimal i koordinatave fillestare (pas një periudhe të shkurtër kohore) kromatike mesatare të përhapura në hapësirë (x dhe y) të një burimi të vetëm drite nga pika qëndrore e kromaticitetit (cx dhe cy) e deklaruar nga prodhuesi ose importuesi, i shprehur si madhësia (në hapa) e elipsës MacAdam të formuar rreth pikës qëndrore të kromaticitetit (cx dhe cy);
65. **"faktori i zhvendosjes (cos φ1)"** është kosinusi i këndit fazor φ1 ndërmjet harmonikës themelore të tensionit të furnizimit në rrjet dhe harmonikës themelore të rrymës së rrjetit. Përdoret për ndriçuesit nga rrjeti duke përdorur teknologjinë LED ose OLED. Faktori i zhvendosjes matet në ngarkesë të plotë, për parametrat e kontrollit referencë aty ku është e zbatueshme, me çdo pjesë të kontrollit të ndriçimit të vendosura në opsionin e kontrollit dhe pjesët jo-ndriçuese të shkëputura, të fikura ose të vendosura në konsumin minimal të energjisë sipas udhëzimeve të prodhuesit;
66. **"faktori i mirëmbajtjes së lumenit"** (X_{LMF}) është raporti i fluksit ndriçues të emetuar nga një ndriçues në një kohë të caktuar të jetës së tij me fluksin fillestar të dritës;
67. **"faktori i mbijetesës"** (SF) është fraksioni i përcaktuar i numrit total të ndriçuesve që vazhdojnë të funksionojnë në një kohë të caktuar në kushte të përcaktuara dhe frekuencë kalimi;
68. **"jetëgjatësia"** për ndriçuesit LED dhe OLED është koha në orë midis fillimit të përdorimit të tyre dhe momentit kur për 50% të numrit të ndriçuesve, prodhimi i dritës bie gradualisht në një vlerë deri nën 70% të fluksit fillestar të dritës. Kjo quhet edhe si $L_{70}B_{50}$ jetëgjatësi;
69. **"mekanizmi i shfaqjes"** është çdo ekran, duke përfshirë ekranin me prekje (touch), ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për shfaqjen e përmbajtjes së internetit tek përdoruesit;
70. **"ekran me prekje"** është një ekran që i përgjigjet prekjes, si p.sh. ai i një kompjuteri tabletë, kompjuteri me ekran ose një smartphone;
71. **"ekran me paraqitje të integruar"** është ndërfaqja pamore në të cilën një imazh ose grup të dhënash aksesohet përmes klikimit të mausit, kalimit të mausit mbi të (rrotullim), ose zgjerimit të ekranit me prekje nga një imazh ose grup tjetër të dhënash.
72. **"tekst alternativ"** është teksti i ofruar si një alternativë kundrejt një figure, që lejon që informacioni të paraqitet në formë jo-figure, ku pajisjet e ekranit nuk mund të prodhojnë vetë figurën ose si një ndihmë për aksesimin, siç është futja e informacionit për aplikacionet e sintezes së zërit;
73. **"Sipërfaqja e projektuar që lëshon dritë"** (A) është sipërfaqja në mm^2 (milimetra katror) e pamjes në një projeksion ortografik të sipërfaqes që lëshon dritë nga drejtimi me intensitetin më të lartë të dritës, ku sipërfaqja që lëshon dritë është sipërfaqja e vetë ndriçuesit, e cila lëshon dritë me karakteristikat e deklaruara optike, të tilla si sipërfaqja afërsisht sferike e një harku (a), sipërfaqja cilindrike e një mbështjelljeje filamenti (b) ose një llambë shkarkimi gazi (c, d), mbështjellja e sheshtë ose gjysmë sferike e një diode që lëshon dritë (e). Për ndriçuesit me një shtresë jo të tejdukshme apo me mburojë kundër shkëlqimit, sipërfaqja e lëshimit të dritës është e gjithë zona përmes së cilës drita largohet nga ndriçuesi. Për ndriçues që përmbajnë më shumë se një emetues drite, projeksioni i vëllimit bruto më të vogël që mbulon të gjithë emetuesit do të merret si sipërfaqe që lëshon dritë. Për ndriçues HID zbatohet përkufizimi (a), përveç nëse dimensionet e përcaktuara në (d) zbatohen me L>D, ku L

është distanca midis majave të elektrodës dhe D diametri i brendshëm i tubit të harkut.



(a) $A=¼\pi D^2$ (b) $A=L\cdot D$ (c) $A=L\cdot D$ (d) $A=L\cdot D$ (e) $A=¼\pi D^2$

74. Kodi **"përgjigje e shpejtë"** (QR) është një barkod matricë i përfshirë në etiketën e energjisë të një modeli produkti që lidhet me informacionin e atij modeli në pjesën publike të bazës së të dhënave të produktit.

III. PËRGJEGJËSITË E FURNIZUESVE TË NDRIÇUESVE

1. Furnizuesit e ndriçuesve sigurojnë që:

a) çdo ndriçues i cili vendoset në treg si produkt i pavarur (dmth. jo i përfshirë në një produkt tjetër) dhe i ambalazhuar, pajiset me një etiketë që të jetë e printuar dhe ngjitur mbi ambalazh, në formatin e përcaktuar në Shtojcën II;

b) parametrat e skedës informative të produktit, ashtu siç përcaktohet edhe në Shtojcën III, futen në bazën e të dhënave të produktit;

c) nëse kërkohet në mënyrë specifike nga tregtari, skeda informative e produktit vihet në

dispozicion në formë të printuar;

ç) përmbajtja e dokumentacionit teknik, ashtu siç përcaktohet edhe në shtojcën IV, futet në bazën e të dhënave të produktit;

d) çdo reklamë pamore për një model specifik ndriçuesi përmban klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të dukshme në etiketë, në përputhje me Shtojcën V dhe Shtojcën VI;

dh) çdo material teknik reklamimi në lidhje me një model specifik ndriçuesi, duke përfshirë materiale teknike reklamimi në internet që përshkruajnë parametrat e tij specifikë teknik, përfshin gjithashtu klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të vendosur dukshëm në etiketë, në përputhje me Shtojcën VI;

e) një etiketë elektronike, në formatin dhe me përmbajtje informacioni sipas përcaktimeve të Shtojcës II, vihet në dispozicion të tregtarëve për çdo model ndriçuesi;

ë) një skedë informative e pajisjes, u vihet në dispozicion tregtarëve në format elektronik për çdo model ndriçuesi, ashtu siç përcaktohet në Shtojcën III;

f) me kërkesë të tregtarëve dhe në përputhje me kreun 4(e), etiketat e printuara , të rishkallëzuara të produkteve ofrohen si ngjitëse, me përmasa të njëjta me atë ekzistueset;

g) për ndriçuesit e vendosur në treg deri më 31 gusht 2021 furnizuesi siguron etiketën ekzistuese, ndërsa për ndriçuesit e vendosur në treg nga 1 shtatori 2021 furnizuesi siguron etiketën e rishkallëzuar.

2. Furnizuesit e produkteve të përbërë sigurojnë që:

a) të japin informacion mbi ndriçuesit që mbarten në këtë pajisje, siç specifikohet në pikën 2 të Shtojcës III;

b) me kërkesë të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, të japin informacion se si mund të hiqen ndriçuesit për verifikim, pa i shkaktuar dëmtim të përhershëm pajisjes që lëshon dritë;

3. Klasa e efiçencës së energjisë llogaritet në përputhje me Shtojcën I;

4. Nga data 1 Mars 2025 Furnizuesit që prodhojnë ndriçues në Republikën e Shqipërisë duhet të plotesojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën VI dhe ta shfaqin në faqen e tyre të internetit përpara se të hedhin në treg një ndriçues të prodhuar pas kësaj date;

5. Për furnizuesit që eksportojnë produktet e prodhuara në Bashkimin Europian, duhet të plotesojnë informacionin e përcaktuar në Shtojcën VI në bazën e të dhënave europiane të produkteve përpara se të hedhin në treg një ndriçues të prodhuar pas kësaj date.

IV. PËRGJEGJËSITË E TREGTARËVE TË NDRIÇUESVE

Tregtarët garantojnë që:

a) në pikën e shitjes, çdo ndriçues që nuk është i përfshirë në një produkt të përbërë, përmban etiketën e dhënë nga furnizuesit në përputhje me pikën 1(a) të kreut III, me etiketën ose klasën e energjisë që shfaqet në mënyrë që të jetë qartësisht e dukshme, në përputhje me Shtojcën II;

b) në rast të shitjes në distancë, jepet etiketa dhe skeda informative e produktit, në përputhje me Shtojcat V dhe VI;

c) çdo reklamë pamore për një model specifik ndriçuesi, duke përfshirë edhe ato në internet, përmban klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të vendosura dukshëm në etiketë, në përputhje me Shtojcën V;

ç) çdo material teknik reklamimi për një model specifik ndriçuesi, duke përfshirë dhe materialin teknik të reklamimit në internet, i cili përshkruan parametrat specifikë teknik përfshin klasën e efiçencës së energjisë të atij modeli dhe gamën e klasave të efiçencës së energjisë të vendosura dukshëm në etiketë, në përputhje me Shtojcën V;

d) etiketat ekzistuese mbi ndriçues në pikat e shitjes të zëvendësohen nga etiketat e ri-shkallëzuara, në mënyrë të tillë që të mbulojnë etiketën ekzistuese, duke përfshirë edhe ato të printuara ose të bashkangjitura në ambalazhim, brenda tetëmbëdhjetë muajve pas zbatimit të kësaj rregulloreje.

V. PËRGJEGJËSITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË HOSTIMIT NË INTERNET

Ofruesi i shërbimit të hostimit që mundëson shitjen e ndriçuesve përmes faqes së tij të internetit, shfaq etiketën elektronike dhe skedën informative elektronike të produktit të ofruar nga tregtari në mekanizmin e ekspozimit, në përputhje me dispozitat e Shtojcës VI, dhe informon tregtarin për detyrimin që ai ka për t'i ekspozuar ato.

VI. METODAT MATJES DHE LLOGARITJES

Informacioni që jepet në përputhje me krerët III dhe IV merret me metoda të besueshme, të sakta dhe të përsëritshme të matjes dhe llogaritjes, të cilat marrin parasysh metodat më moderne të matjes dhe llogaritjes, siç përcaktohet në Shtojcën I.

VII. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR QËLLIME TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen tregut është Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut i cili do të zbatojë procedurën e përcaktuar në shtojcën VII të kësaj rregulloreje.

VIII. SHFUQIZIMI

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Vendimi Nr. 942, datë 28.12.2016.

SHTOJCA I

Klasat e efiçiencës së energjisë dhe metoda e llogaritjes

Klasa e efiçencës së energjisë së ndriçuesve përcaktohet sipas Tabelës 1, në bazë të efiçencës totale të rrjetit η_{TM}, e cila llogaritet duke pjesëtuar fluksin e dobishëm të dritës të deklaruar $\Phi_{përdorimi}$ (shprehur në lm) me konsumin e deklaruar të energjisë në opsionin e aktivizuar $P_{në}$(shprehur në W) dhe duke e shumëzuar me faktorin e aplikueshëm F_{TM} të tabelës 2, si më poshtë:

$\eta_{TM} = (\Phi_{përdorimi}/P_{on}) \times F_{TM}(lm/W)$.

Tabela 1

Klasat e efiçencës së energjisë të ndriçuesve

Klasa e efiçencës së energjisë	Efiçenca totale e rrjetit ηTM (lm/W)
A	$210 \leq \eta TM$
B	$185 \leq \eta TM < 210$
C	$160 \leq \eta TM < 185$
D	$135 \leq \eta TM < 160$
E	$110 \leq \eta TM < 135$
F	$85 \leq \eta TM < 110$
G	$\eta TM < 85$

Tabela 2

Faktorët F_{TM} sipas llojit të ndriçuesit

Lloji i ndriçuesit	Faktori FTM
Jo-të drejtuar (NDLS) që funksionojnë në rrjet (MLS)	1000
Jo-të drejtuar (NDLS) që nuk funksionojnë në rrjet (NMLS)	0,926
Të drejtuar (DLS) që funksionojnë në rrjet (MLS)	1176
Të drejtuar (DLS) që nuk funksionojnë në rrjet (NMLS)	1089

SHTOJCA II

Etiketa e ndriçuesve

1. ETIKETA

Ndriçuesit që tregtohet përmes një pike shitjeje pajisen me një etiketë të printuar në ambalazhin individual të tyre, në formatin dhe që përmban informacionin e përcaktuar në këtë shtojcë.

Furnizuesit zgjedhin një nga formatet e etiketave të radhitura në pikat 1.1 deri 1.2 të kësaj shtojce.

Etiketa ka përmasat si më poshtë:

a) për etiketën me madhësi standarde, të paktën 36 mm e gjerë dhe 75 mm e lartë;

b) për etiketën me përmasa të vogla (gjerësia më e vogël se 36 mm), të paktën 20 mm e gjerë dhe 54 mm e lartë.

Paketimi ose ambalazhimi nuk duhet të jetë më i vogël se 20 mm i gjerë dhe 54 mm i lartë.

Kur etiketa printohet në një format më të madh, gjithsesi përmbajtja e saj duhet t'u përmbahet përmasave me specifikimet e mësipërme. Etiketa me përmasa të vogla nuk duhet të përdoret në ambalazhe me gjerësi 36 mm ose më shumë.

Etiketa dhe shigjeta që tregon klasën e efiçencës së energjisë mund të printohen në figurë njëngjyrëshe, siç përcaktohet në pikat 1.1 dhe 1.2, vetëm nëse të gjitha informacionet e tjera, duke përfshirë figurat e ambalazhit, janë të printuara me figura njëngjyrëshe.

Nëse etiketa nuk printohet në pjesën e ambalazhit të përgatitur për klientin e mundshëm, do të tregohet një shigjetë që përmban gërmën e klasës së efiçencës së energjisë si më poshtë, me ngjyrën e shigjetës që përputhet me shkronjën dhe ngjyrën e klasës së energjisë. Madhësia duhet të jetë e tillë që etiketa të jetë e dukshme dhe e lexueshme qartë. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës së energjisë do të jetë Calibri Bold dhe e vendosur në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës, me një largësi anësore prej 0,5 pt, shigjeta së bashku me germën e klasës së efiçencës të vijëzuara rreth e rrotull me një vijë 100% të zezë.

Figura 1

Shigjeta me ngjyra/monokrom majtas/djathtas për pjesën e ambalazhit që do të jetë përballë klientit të mundshëm



Në rastin e përmendur në pikën (d) të kreut 4, etiketa e ri shkallëzuar duhet të ketë formatin dhe madhësinë që mundësojë mbulimin dhe të ngjitet mbi etiketën e vjetër.

1.1. Etiketa me madhësi standarde:

Etiketa paraqitet si më poshtë:





1.2. Etiketa me përmasa të vogla:

Etiketa paraqitet si më poshtë:





1.3. Informacioni i mëposhtëm përfshihet në etiketën për ndriçuesit:

I. Emri i furnizuesit ose marka/kodi tregtar i tij;

II. Identifikuesi i modelit të furnizuesit ;

III. Shkalla e efiçencës së energjisë nga A deri në G;

IV. Konsumimi i energjisë, shprehur në kWh orë të konsumit të energjisë elektrike për 1 000 orë të burimit të dritës ku ai është i ndezur;

V. Kodi QR;

VI. Klasa e efiçencës së energjisë, në përputhje me Shtojcën I;

VII. Numri i Rregullores së Deleguar të Komisionit për etiketimin e ndriçuesve që është "2019/2015".

2. SKICIMI E ETIKETAVE

2.1. Etiketa me madhësi standarde:


2
36 mm
1,5 mm
1,5 mm
1,5 mm
1
6 mm
4,5 mm
SUPPLIER'S NAME
3
4 mm
MODEL IDENTIFIER
4
1,5 mm
1,5 mm
6
4,5 mm
5
A
11 mm
1 mm
B
7
6 mm
4,5 mm
1 mm
C
4,5 mm
1 mm
D
72 mm
4,5 mm
1 mm
E
4,5 mm
1 mm
F
4,5 mm
1 mm
G
4,5 mm
1,5 mm
6
2 mm
9
5 mm
8
WXYZ
kWh/1000h
2019/2015
10,5 mm
3 mm
2,5 mm
1,5 mm
10
10,5 mm
8,5 mm
9,6 mm
10,9 mm
12,2 mm
13,4 mm
14,7 mm
16 mm

2.2. Etiketa me përmasa të vogla:



2.3. Ku:

(a) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketat janë siç tregohet në paragrafin 1 të Shtojcës II dhe në skicimin e etiketave për etiketat me përmasa standarde dhe të vogla për ndriçuesit.

(b)Sfondi i etiketës është 100% në ngjyrë të bardhë.

(c)Shkronjat janë në formatin Verdana dhe Calibri.

(ç)Ngjyrat janë CMYK - cian, purpurtë, e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: 0-70-100-0: 0% cian, 70% magenta, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(d)Etiketat plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurave të

mësipërme):

1. ngjyrat e logos së BE-së do të jenë si më poshtë:
   - sfondi: 100,80,0,0;
   - yjet: 0,0,100,0;
2. ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100,80,0,0;
3. emri i furnizuesit duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë dhe në formatin Verdana Bold 8 pt – 5 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla);
4. identifikuesi i modelit duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë dhe në formatin Verdana Regular 8 pt – 5 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla);
5. shkalla A deri në G është si më poshtë:
   - shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100 % në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja në formatin Calibri Bold 10,5 pt – 7 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla); shkronjat duhet të përqëndrohen në një bosht në 2 mm - 1,5 mm (me madhësi standarde - etiketë me madhësi të vogël) nga ana e majtë e shigjetave;
   - ngjyrat e shigjetave të shkallës A deri në G janë si më poshtë:
     - A-klasa: 100,0,100,0;
     - B-klasa: 70,0,100,0;
     - C-klasa: 30,0,100,0;
     - D-klasa: 0,0,100,0;
     - E-klasa: 0,30,100,0;
     - F-klasa: 0,70,100,0;
     - G-klasa: 0,100,100,0;
6. ndarësit e brendshëm duhet të kenë një madhësi prej 0,5 pt dhe ngjyra duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë;
7. shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% në ngjyrë të bardhë dhe në formatin Calibri Bold 16 pt – 10 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla). Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën A deri në G duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës energjetike duhet të vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës e cila duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë;
8. vlera e konsumit të energjisë duhet të jetë në Verdana Bold 12 pt; 'kWh/1 000h' do të jetë në Verdana Regular 8 pt – 5 pt (me madhësi standarde – etiketë me përmasa të vogla), 100 % në ngjyrë të zezë;
9. kodi QR duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë;

10. numri i rregullores duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë dhe në formatin Verdana Regular 5 pt.

2.4. Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto ndriçues prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.



Ku:

(a) Dimensionet dhe specifikimet e elementeve që përbëjnë etiketat duhet të jenë siç tregohet në paragrafin 1 të Shtojcës II dhe në skicimin e etiketave për etiketat me përmasa

standarde dhe të vogla për ndriçuesit.

(b)Sfondi i etiketës duhet të jetë 100% në ngjyrë të bardhë.

(c)Shkronjat do të jenë në formatin Verdana dhe Calibri;

(ç)Ngjyrat duhet të jenë CMYK - cian, purpurtë, e verdhë dhe e zezë, duke ndjekur këtë shembull: 0-70-100-0: 0% cian, 70% magenta, 100% e verdhë, 0% e zezë.

(d)Etiketat duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurave të mësipërme):

1. ngjyrat e logos së Shqipërisë-së do të jenë si më poshtë:
   - sfondi: 5,99,100,1;
   - shqiponja: 0,0,0,100;
2. ngjyra e logos së energjisë duhet të jetë: 100,80,0,0;
3. emri i furnizuesit duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë dhe në formatin Verdana Bold 8 pt – 5 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla);
4. identifikuesi i modelit duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë dhe në formatin Verdana Regular 8 pt – 5 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla);
5. shkalla A deri në G do të jetë si më poshtë:
   - shkronjat e shkallës së efiçencës së energjisë duhet të jenë 100 % në ngjyrë të bardhë dhe me shkronja në formatin Calibri Bold 10,5 pt – 7 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla); shkronjat duhet të përqendrohen në një bosht në 2 mm - 1,5 mm (me madhësi standarde - etiketë me madhësi të vogël) nga ana e majtë e shigjetave;
   - ngjyrat e shigjetave të shkallës A deri në G do të jenë si më poshtë:
     - A-klasa: 100,0,100,0;
     - B-klasa: 70,0,100,0;
     - C-klasa: 30,0,100,0;
     - D-klasa: 0,0,100,0;
     - E-klasa: 0,30,100,0;
     - F-klasa: 0,70,100,0;
     - G-klasa: 0,100,100,0;
6. ndarësit e brendshëm duhet të kenë një madhësi prej 0,5 pt dhe ngjyra duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë;
7. shkronja e klasës së efiçencës së energjisë duhet të jetë 100% në ngjyrë të bardhë dhe në formatin Calibri Bold 16 pt – 10 pt (etiketë me përmasa standarde – me përmasa të vogla). Shigjeta e klasës së efiçencës së energjisë dhe shigjeta përkatëse në shkallën A deri në G duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që majat e tyre të jenë të rreshtuara. Shkronja në shigjetën e klasës së efiçencës energjetike duhet të

vendoset në qendër të pjesës drejtkëndore të shigjetës e cila duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë;

8. vlera e konsumit të energjisë duhet të jetë në Verdana Bold 12 pt; 'kWh/1 000h' do të jetë në formatin Verdana Regular 8 pt – 5 pt (me madhësi standarde – etiketë me përmasa të vogla), 100 % në ngjyrë të zezë;
9. kodi QR duhet të jetë 100% në ngjyrë të zezë;
10. numri i kësaj rregulloreje i cili duhet të jetë 100 % në ngjyrë të zezë dhe në formatin Verdana Regular 5 pt.

.

SHTOJCA III

Informacioni i produktit

1. Skeda informative e produktit

Në bazë të pikës 1(b) të kreut IV, furnizuesi vendos në bazën e të dhënave të produktit informacionin e përcaktuar në tabelën 3, duke përfshirë rastin kur ndriçuesi është pjesë e një produkti të përbërë.

Tabela 3

Skeda informative e produktit

Emri i furnizuesit ose marka tregtare:			
Adresa e furnizuesit:			
Identifikimi i modelit:			
Lloji i ndriçuesit:			
Teknologjia e përdorur e ndriçimit:	[HL/LFL T5 HE/LFL T5 HO/CFLni/të tjera FL/HPS/MH/të tjera HID/LED/OLED/të përziera/të tjera]	Jo- i drejtuar ose i drejtuar:	[NDLS/DLS]
Rrjeti elektrik ose jo:	[MLS/NMLS]	Ndriçues i lidhur (CLS):	[po/jo]

Ndriçues i rregullueshëm me ngjyra:	[po/jo]	Mbështjellëse:	[jo / sekondë / jo e qartë]
Ndriçues me ndriçim të lartë:	[po/jo]		
Mburojë kundër shkëlqimit:	[po/jo]	E rregullueshme (Zbehje)	[po/vetëm me zbehës specifikë/jo]
Parametrat e produktit			
Parametri	Vlera	Parametri	Vlera
Parametrat e përgjithshëm të produktit:			
Konsumi i energjisë në modalitetin aktiv (ndezur) (kWh/1 000 h)	x	Klasa e efiçencës së energjisë	[A/B/C/D/E/F/G]
Fluks i dobishëm ndriçues (Φ_{use}), që tregon nëse i referohet fluksit në një sferë (360°), në një kon të gjerë (120°) ose në një kon të ngushtë (90°)	x në [sferë/kon i gjerë/kon i ngushtë]	Temperatura përkatëse e ngjyrave, e përafruar në 100 K më të afërt, ose diapazoni i temperaturave përkatëse të ngjyrave, i rrumbullakosur në 100 K më të afërt ku mund të vendoset	[x/x…x]
Fuqia në opsionin ndezur (ON) (P_{on}), e shprehur në W	x, x	Fuqia në gjendjen në gatishmëri (standby) (P_{s}), e	x, xx

			shprehur në W dhe e rrumbullakosur në shifrën e dyte dhjetore	
Fuqia e gatishmërisë (standby) në rrjet (P_{net}) për CLS, e shprehur në W dhe e rrumbullakosur shifrën dyte dhjetore		x, xx	Indeksi i paraqitjes së ngjyrave, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, ose diapazoni i vlerave CRI që mund të vendosen	[x/x…x]
Përmasat e jashtme pa pajisje të veçanta kontrolli, pjesë kontrolli ndriçimi dhe pjesë kontrolli jo ndriçuese, nëse ka (milimetra)	Lartësia	x	Shpërndarja spektrale e fuqisë në intervalin 250 nm deri në 800 nm, me ngarkesë të plotë	[grafike]
	Gjerësia	x		
	Thellësi	x		
Shpallja e fuqisë ekuivalente		[po/-]	Nëse po, fuqia ekuivalente (W)	x
			Koordinatat e kromaticitetit (x dhe y)	0, xxx 0, xxx
Parametrat për ndriçues të drejtuar:				
Intensiteti maksimal i ndricimit (cd)		x	Këndi i rrezes në gradë, ose	[x/x…x]

		diapazoni i këndeve të rrezeve që mund të vendosen	
Parametrat për ndriçues LED dhe OLED:			
Vlera e indeksit të paraqitjes së ngjyrave R9	x	Faktori i mbijetesës	x, xx
faktori i mirëmbajtjes së lumenit	x, xx		
Parametrat për ndriçues së rrjetit LED dhe OLED:			
faktori i zhvendosjes (cos φ1)	x, xx	Konsistenca e ngjyrave në elipset McAdam	x
tregues se një ndriçues LED zëvendëson një ndriçues fluoreshent pa zhivë të integruar për një fuqi vat të caktuar.	[po/-]	Nëse po, atëherë kërkesë për zëvendësim (W)	x
Metrika e dridhjes (Pst LM)	x, x	Metrika e efektit stroboskopik (SVM)	x, x

Tabela 4

Referenca e fluksit ndriçues për deklarime ekuivalence

Lloji i reflektorit me tension tej mase të ulët		
Lloji	**Fuqia (W)**	**Referenca Φ90° (lm)**
MR11 GU4	20	160

	35	300
MR16 GU 5.3	20	180
	35	300
	50	540
AR111	35	250
	50	390
	75	640
	100	785
Lloji i reflektorit me xham me fryrje me tension nga rrjeti		
Lloji	**Fuqia (W)**	**Referenca Φ90° (lm)**
R50/NR50	25	90
	40	170
R63/NR63	40	180
	60	300
R80/NR80	60	300
	75	350
	100	580
R95/NR95	75	350
	100	540
R125	100	580

	150	1000
Lloji i reflektorit me xham të presuar me tension nga rrjeti		
Lloji	**Fuqia (W)**	**Referenca Φ90° (lm)**
PAR16	20	90
	25	125
	35	200
	50	300
PAR20	35	200
	50	300
	75	500
PAR25	50	350
	75	550
PAR30S	50	350
	75	550
	100	750
PAR36	50	350
	75	550
	100	720
PAR38	60	400
	75	555

	80	600
	100	760
	120	900

Tabela 5

Faktorët e shumëzimit për mirëmbajtjen e lumenit

Lloji i ndriçuesit	**Faktori i shumëzimit të fluksit të dritës**
ndriçues halogjen	1
ndriçues fluoreshent	1,08
ndriçues LED	1 + 0,5 × (1 - LLMF) ku LLMF është faktori i mirëmbajtjes së lumenit në fund të jetëgjatësisë së deklaruar

Tabela 6

Faktorët e shumëzimit për ndriçuesit LED

Këndi i rrezes së ndriçuesit LED	**Faktori i shumëzimit të fluksit të dritës**
Këndi i rrezes 20° ≤	1
15° ≤ këndi i rrezes < 20°	0,9
10° ≤ këndi i rrezes < 15°	0,85
këndi i rrezes < 10°	0,80

Tabela 7

Treguesit e ekuivalencës për ndriçuesit jo-të drejtuar

Fluksi ndriçues i vlerësuar i ndriçuesit Φ (lm)	Fuqia ekuivalente e ndriçuesit inkandeshent e pretenduar (W)
136	15
249	25
470	40
806	60
1055	75
1 521	100
2 452	150
3 452	200

Tabela 8

Vlerat minimale të efiçencës për ndriçuesit T8 dhe T5

T8 (26 mm Ø)		T5 (16 mm Ø) Efikasitet i lartë		T5 (16 mm Ø) Prodhim i lartë	
Fuqia ekuivalente e treguar (W)	**Efiçenca minimale ndriçuese (lm/W)**	**Fuqia ekuivalente e pretenduar (W)**	**Efiçenca minimale ndriçuese (lm/W)**	**Fuqia ekuivalente e treguar (W)**	**Efiçenca minimale ndriçuese (lm/W)**
15	63	14	86	24	73
18	75	21	90	39	79
25	76	28	93	49	88
30	80	35	94	54	82

36	93			80	77
38	87				
58	90				
70	89				

Për ndriçues që mund të rregullohen për të lëshuar dritë me ngarkesë të plotë me karakteristika të ndryshme, vlerat e parametrave që ndryshojnë me këto karakteristika duhet të raportohen në parametrat e kontrollit të referencës.

Nëse ndriçuesi nuk vendoset më në tregun e BE-së, furnizuesi duhet të vendosë në bazën e të dhënave të produktit datën (muajin, vitin) kur është ndalur vendosja në tregun e BE-së.

2. Informacioni që shfaqet në dokumentacionin e një produkti të përbërë

Nëse një ndriçues vendoset në treg si pjesë e një produkti të përbërë, dokumentacioni teknik për produktin e përbërë duhet të identifikojë qartë ndriçuesit që përmban, duke përfshirë klasën e efiçencës së energjisë.

Nëse një ndriçues vendoset në treg si pjesë e një produkti të përbërë, në manualin e përdorimit ose broshurën e udhëzimeve duhet të shfaqet teksti i mëposhtëm në mënyrë të qartë, të lexueshme,:

"Ky produkt përmban një ndriçues të klasës së efiçencës së energjisë <X>",

ku <X> do të zëvendësohet nga klasa e efiçencës energjetike të ndriçuesit të mbartur.

Nëse produkti përmban më shumë se një ndriçues, fjalia mund të jetë në shumës ose të përsëritet për çdo ndriçues, sipas rastit.

3. Informacioni që shfaqet në faqen e internetit të furnizuesit, me akses falas:

(a) Cilësimet e kontrollit të referencës dhe udhëzimet se si ato mund të zbatohen, aty ku është e zbatueshme;

(b)Udhëzime se si të hiqni pjesët e kontrollit të ndriçimit dhe/ose pjesët jo ndriçuese, nëse ka, ose si t'i fikni ose minimizoni konsumin e tyre të energjisë;

(c)Nëse ndriçuesi mund të zvogëlohet (ulet/ngrihet): një listë e dimeruesve (rregullatorëve të ndriçimit ose zbehësit) me të cilën është e përputhshme, dhe standardi(et) e përputhshmërisë së dimeruesit të ndriçuesit me të cilat është në përputhje, nëse ka;

(ç)Nëse ndriçuesi përmban zhivë: udhëzime se si të pastrohen mbeturinat në rast të thyerjes aksidentale;

(d)Rekomandime se si të asgjësohet burimi i dritës në fund të jetës së tij.

SHTOJCA IV

Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik i përmendur në pikën 1(ç) të kreut IV përfshin:

(a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) identifikuesin e modelit të furnizuesit;

(c) identifikuesin e modelit dhe të të gjitha modeleve të barasvlefshme të vendosura tashmë në treg;

(ç) identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të lidhur furnizuesin;

(d) vlerat e deklaruara dhe të matura për parametrat teknikë të mëposhtëm :

1. fluks i dobishëm ndriçues ($\Phi_{\text{përdorni}}$) në lm;
2. indeksi i paraqitjes së ngjyrave (CRI);
3. fuqia në modalitet aktiv (ndezur) ($P_{\text{në}}$) në W;
4. këndi i rrezes në gradë për ndriçues të drejtuar (DLS);
5. temperatura përkatëse e ngjyrave (CCT) në K për ndriçues FL dhe HID;
6. fuqia e gatishmërisë (P_{sb}) në W, duke përfshirë kur është zero;
7. fuqia e gatishmërisë (standby) në rrjet (P_{neto}) në W për ndriçues të lidhur (CLS);
8. faktori i zhvendosjes (cos φ1) për ndriçues të rrjetit LED dhe OLED;
9. konsistenca e ngjyrave në hapat e elipsit MacAdam për ndriçues LED dhe OLED;
10. ndriçimi-HLLS në cd/mm^2(vetëm për HLLS)
11. matësi i dridhjeje (PstLM) për ndriçues LED dhe OLED;
12. matësi i efektit stroboskopik (SVM) për ndriçues LED dhe OLED;
13. pastërtia e ngacmimit, vetëm për CTLS, për ngjyrat e mëposhtme dhe gjatësinë e valës dominuese brenda intervalit të caktuar:

Ngjyrë	Gama dominuese e gjatësisë së valës
Blu	440 nm - 490 nm
E gjelbër	520 nm - 570 nm
E kuqe	610 nm - 670 nm

(dh) llogaritjet e kryera me parametrat, duke përfshirë përcaktimin e klasës së efiçencës së energjisë;

(e) referenca për standardet e harmonizuara të aplikuara ose standarde të tjera të përdorura;

(ë) kushtet e testimit nëse nuk përshkruhen mjaftueshëm në pikën (g);

(f) parametrat e kontrollit të referencës dhe udhëzimet se si ato mund të zbatohen, aty ku është e aplikueshme;

(g) udhëzime se si të hiqen pjesët e kontrollit të ndriçimit dhe/ose pjesët jo ndriçuese, nëse ka, ose si t'i fikni ose minimizoni konsumin e tyre të energjisë gjatë testimit të ndriçuesit;

(gj) masa paraprake specifike që duhet të merren kur modeli montohet, instalohet, mirëmbahet ose testohet.

SHTOJCA V

Informacioni që jepet në reklamat pamore, në materialet promovuese teknike dhe në shitjet në distancë, përveç shitjeve në distancë në internet.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺ **Funksioni i ngrohjes së ujit:**

-**Piktogrami** siç përshkruhet, duke përfshirë profilin e deklaruar të ngarkesës të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI: shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, 100% në ngjyrë të zezë.

❻ **AG ose A^{+}-F:**

- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim .

❼ **Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit:**

-**Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, shkronja kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❽ **Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "YZ":** shkronjat në formatin Calibri bold 15 pt, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "dB":** Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❾ **Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit ose GJ/vit:**

-**Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,

-**Vlerat "WXYZ" ose "YZ":** në formatin Calibri, të paktën, 13 pt, 100 % në ngjyrë të zezë,

-**Teksti "kWh/vjetor" ose "GJ/vjetor":** shkronjat në formatin Calibri regular, të paktën, 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❿ **Harta diellore evropiane dhe katrorët me ngjyra:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Ngjyrat**: Blu e errët: 86-51-00-00,
  Blu e mesme: 53-08-00-00,
  Blu e hapur: 25-00-02-00.

⓫ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Rregullores:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

⓬ **Emri i furnizuesit ose marka tregtare.**

⓭**Identifikuesi i modelit të furnizuesit:**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

6. Projektimi i etiketës për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie është si më poshtë:



Ku:

(a)Etiketa është, së paku, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është i bardhë.

(c)Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, ngjyrë e purpurt, ngjyrë e verdhë dhe në ngjyrë të zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % ngjyrë e purpurt, 100 % ngjyrë e verdhë, 0 % në ngjyrë të zezë.

(d)Etiketa plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ **Shtrirja e kufirit të etiketës BE:** 4 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺ **Funksioni i ngrohjes së ujit:**

-**Piktogrami** siç përshkruhet, duke përfshirë profilin e deklaruar të ngarkesës të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI: shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, 100% në ngjyrë të zezë.

❻ **AG ose A^{+}-F:**

- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❼ **Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit:**

-**Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, shkronja kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❽ **Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda (nëse ka) dhe jashtë:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,

-**Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,

-**Vlera "YZ":** në formatin Calibri bold 15 pt, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti "dB":** shkronjat në formatin Calibri regular 10 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❾ **Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit ose GJ/vit:**

-**Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,

-**Vlerat "WXYZ" ose "YZ":** në formatin Calibri, të paktën, 13 pt, 100 % në ngjyrë të zezë,

-**Teksti "kWh/vjetor" ose "GJ/vjetor":** shkronjat në formatin Calibri regular, të paktën, 11 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❿ **Harta evropiane e temperaturës dhe katrorët me ngjyra:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Ngjyrat** : Blu e errët: 86-51-00-00,
  Blu e mesme: 53-08-00-00,
  Blu e hapur: 25-00-02-00.

⓫ **Nëse është e aplikueshme, përshtatja jashtë pikut:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet,
- **Korniza:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

⓬ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Rregullores:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

⓭ **Emri i furnizuesit ose marka tregtare.**

⓮ **Identifikuesi i modelit të furnizuesit:**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

7. Projektimi i etiketës për depozitat e ujit të ngrohtë është si më poshtë:



Ku:

(a)Etiketa është, të paktën, 105 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është në ngjyrë të bardhë.

(c)Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, ngjyrë e purpurt, ngjyrë e verdhë dhe ngjyrë e zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % ngjyrë e purpurt, 100 % ngjyrë e verdhë, 0 % ngjyrë e zezë.

(d)Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ **Shtrirja e kufirit të etiketës BE:** 4 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 86 mm, lartësia: 17 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 1 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 86 mm.

❺ **Funksioni i ruajtjes:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet.

❻ **AG ose A^{+}-F:**

- **Shigjeta:** lartësia: 7 mm, hapësira: 1 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e fundit: 00-XX-00,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 16 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❼ **Klasa e efiçencës së energjisë:**

- **Shigjeta:** gjerësia: 22 mm, lartësia: 12 mm, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 24 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simboli "+": mbishkrim.

❽ **Humbje në këmbë:**

- **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "YZ":** në formatin Calibri bold 45 pt, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "Ë":** shkronjat në formatin Calibri regular 30 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❾ **Vëllimi i ruajtjes:**

- **Kufiri:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm,
- **Vlera "XYZ":** në formatin Calibri bold 45 pt, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti "L":** shkronjat në formatin Calibri regular 30 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❿ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Rregullores:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 10 pt.

⓫ **Emri i furnizuesit ose marka tregtare.**

⓬ **Identifikuesi i modelit të furnizuesit:**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 86 × 12 mm.

8. Projektimi i etiketës për paketat e përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore është si më poshtë:



Ku:

(a)Etiketa është, së paku, 210 mm e gjerë dhe 297 mm e lartë. Megjithatë, kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj mbetet proporcionale me specifikimet e mësipërme.

(b) Sfondi është në ngjyrë të bardhë.

(c)Ngjyrat janë të koduara si CMYK - cian, ngjyrë e purpurt, ngjyrë e verdhë dhe ngjyrë e zezë, dhe ndjekin këtë shembull: 00-70-X-00: 0 % cian, 70 % ngjyrë e purpurt, 100 % ngjyrë e verdhë, 0 % ngjyrë e zezë.

(d)Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ **Shtrirja e kufirit të etiketës BE:** 6 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❷ **Logoja e BE-së:** Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:** Ngjyra: X-00-00-00. Piktogrami siç përshkruhet: Logoja e BE-së + etiketa e energjisë: gjerësia: 191 mm, lartësia: 37 mm.

❹ **Kufiri i nën-logos:** 2 pt, ngjyra: cian 100 %, gjatësia: 191 mm.

❺ **Funksioni i ngrohjes së ujit:**

-**Piktogrami** siç përshkruhet, duke përfshirë profilin e deklaruar të ngarkesës të shprehur si shkronja e duhur në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI: në formatin Calibri bold 22 pt, 100 % në ngjyrë të zezë.

❻ **Ngrohësi i ujit:**

- **Piktogrami** siç përshkruhet.
- **Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e ngrohësit të ujit:**
- **Shigjeta:** gjerësia: 24 mm, lartësia: 14 mm, 100% në ngjyrë të zezë,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 28 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë,
- **Kufiri:** 3 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❼ **Paketa e përbëra nga kolektori diellor dhe/ose depozita e ujit të ngrohtë:**

- **Piktogramet** siç përshkruhen,
- **Simboli "+":** në formatin Calibri bold 50 pt, cyan 100 %,
- **Kutitë:** gjerësia: 12 mm, lartësia: 12 mm, kufiri: 4 pt, cian 100 %,
- **Kufiri:** 3 pt – ngjyra: cian 100 % – këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❽ **Shkalla A^{+++}-G me kufi:**

- **Shigjeta:** lartësia: 15 mm, hapësira: 3 mm, ngjyrat:
  - Klasa më e lartë: X-00-X-00,
  - Klasa e dytë: 70-00-X-00,
  - Klasa e tretë: 30-00-X-00,
  - Klasa e katërt: 00-00-X-00,
  - Klasa e pestë: 00-30-X-00,
  - Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
  - Klasa e shtatë: 00-XX-00,
  - Nëse është e aplikueshme, klasat e fundit: 00-XX-00,
- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 30 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simbolet "+": mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm,
- **Kufiri:** 3 pt, ngjyra: cian 100 %, këndet e rrumbullakëta: 3,5 mm.

❾ **Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e paketës së ngrohësit të ujit dhe pajisjes diellore:**

- **Shigjeta:** gjerësia: 33 mm, lartësia: 19 mm, 100% në ngjyrë të zezë,

-**Teksti:** shkronjat në formatin Calibri 40 pt, kapitale, në ngjyrë të bardhë, simbolet "+": mbishkrim, rreshtuar në një rresht të vetëm.

⑩ **Viti i prezantimit të etiketës dhe numri i Rregullores:**

- **Teksti:** shkronjat në formatin Calibri bold 12 pt.

⑪ **Emri ose marka tregtare e shitësit dhe/ose furnizuesit.**

⑫ **Identifikuesi i modelit të shitësit dhe/ose furnizuesit:**

Emri i shitësit dhe/ose furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikuesi i modelit vendosen në një hapësirë prej 191 × 19 mm.

Etiketa për produktet e prodhuara në Republikën e Shqipërisë

Prodhuesit të cilët realizojnë prodhimin e produkteve me ndikim në energji sipas kësaj rregulloreje në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të vendosin logon e BE (Bashkimit Evropian) në etiketat e produkteve që janë të destinuar për shitje në tregun lokal, të cilët nuk janë rregjistruar në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian. Për këto produkte me ndikim në energji prodhuesit përdorin etiketën si më poshtë, dhe duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin sipas shtojcës III. Kodi QR në etiketë duhet të ridrejtojë përdoruesin në faqen e internetit të prodhuesit ku mund të marrë informacion për produktin.

SHTOJCA III
Skeda informative e produktit

1. NGROHËSIT E UJIT

1.1. Informacioni në skedën informative të produktit të ngrohësit të ujit jepet në rendin e mëposhtëm dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që jepet me produktin:

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b) Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

(c) Profili i deklaruar i ngarkesës, i shprehur me shkronjën përkatëse dhe përdorimi tipik në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI ;

(d) Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të modelit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I, ku: për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike;

(e) Efiçenca e energjisë e ngrohjes së ujit në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 3 të Shtojca VII, ku: për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike;

(f) Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë finale dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma të *GCV*-së , i rrumbullakosur në numrin më të afërt të plotë dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII, ku: për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, në kushte mesatare klimatike;

(g) Nëse është e aplikueshme, profile të tjera ngarkese, për të cilat ngrohësi i ujit është i përshtatshëm për t"u përdorur dhe efiçenca përkatëse e energjisë së ngrohjes së ujit dhe konsumi vjetor i energjisë elektrike siç përcaktohet në pikat (e) dhe (f);

(h) Parametrat e temperaturës së termostatit të ngrohësit të ujit, të vendosur në treg nga furnizuesi;

(i) Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, në mjedise të mbyllura, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, nëse është e aplikueshme);

(j) Nëse është e aplikueshme, një tregues se ngrohësi i ujit është në gjendje të punojë vetëm gjatë orëve jashtë pikut;

(k) Çdo masë paraprake specifike që merret kur ngrohësi i ujit montohet, instalohet ose mirëmbahet;

(l) Kur vlera e *smart* është deklaruar si "1", një tregues që informacioni për efiçencën e energjisë së ngrohjes së ujit, konsumin vjetor të energjisë elektrike dhe të lëndëve djegëse, sipas rastit, lidhet vetëm me cilësimet e aktivizuara të kontrollit inteligjent;

përveç kësaj, për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:

(m)Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe të llogaritur në përputhje me pikën 3 të Shtojcës VII;

(n)Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kWh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndë djegëse në GJ në terma të *GCV*-së , në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe të llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII;

Përveç kësaj, për ngrohësit diellorë të ujit:

(o) Zona e hapjes së kolektorit në m^2, deri në dy shifra dhjetore;

(p) Efiçenca me zero humbje, deri në tre shifra dhjetore;

(q) Koefiçienti i rendit të parë në W /(m^2 K), në dy shifra dhjetore;

(r) Koefiçienti i rendit të dytë në W /(m^2 K^2), në tre shifra dhjetore;

(s) Modifikuesi i këndit të incidencës, në dy shifra dhjetore;

(t) Vëllimi i ruajtjes në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(u)Konsumi i energjisë së pompës në Ë, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(v) Konsumi i energjisë në gatishmëri në Ë, deri në dy shifra dhjetore;

Përveç kësaj, për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:

(ë)Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA}, jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

1.2.Një skedë mund të mbulojë një numër modelesh ngrohësish uji të furnizuar nga i njëjti furnizues.

1.3.Informacioni i përfshirë në skedë mund të jepet në formën e një kopje të etiketës, me ngjyra ose bardh e zi. Kur ndodh kjo, atëherë jepet edhe informacioni i renditur në pikën 1.1 që nuk është shfaqur tashmë në etiketë.

2. DEPOZITA E UJIT TË NGROHTË

2.1.Informacioni në skedën e produktit të depozitës së ujit të ngrohtë jepet në rendin e mëposhtëm dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që jepet me produktin:

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b) Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

(c)Klasa e efiçencës së energjisë së modelit, e përcaktuar në përputhje me pikën 2 të Shtojcës I;

(d) Humbja termike në W, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(e) Vëllimi i ruajtjes në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

2.2.Një skedën informative të produktit mund të mbulojë një numër modelesh depozitash të ujit të ngrohtë të furnizuar nga i njëjti furnizues.

2.3.Informacioni i përfshirë në skedën informative të produktit mund të jepet në formën e një kopje të etiketës, me ngjyra ose bardh e zi. Kur ndodh kjo, atëherë jepet gjithashtu informacioni i renditur në pikën 2.1 që nuk është shfaqur tashmë në etiketë.

3. PAJISJET DIELLORE

3.1.Informacioni në skedën informative të produktit të pajisjes diellore jepet në rendin e mëposhtëm dhe përfshihet në broshurën e produktit ose në literaturën tjetër që jepet me produktin (për pompat në unazën e kolektorit, nëse është e aplikueshme):

(a) Emri i furnizuesit ose marka tregtare;

(b) Identifikuesi i modelit të furnizuesit;

(c) Zona e hapjes së kolektorit në m^2, deri në dy shifra dhjetore;

(d) Efiçenca me humbje zero, deri në tre shifra dhjetore;

(e) Koefiçienti i rendit të parë në $W/(m^2 K)$, në dy shifra dhjetore;

(f) Koefiçienti i rendit të dytë në $W/(m^2 K^2)$, në tre shifra dhjetore;

(g) Modifikuesi i këndit të incidencës, në dy shifra dhjetore;

(h) Vëllimi i ruajtjes në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(i)Kontributi vjetor i nxehtësisë jo diellore Q_{nonsol} në kWh për sa i përket energjisë parësore për energjinë elektrike dhe/ose në kWh për sa i përket *GCV*-së për lëndët djegëse, për profilet e ngarkesës M, L, XL dhe XXL në kushte mesatare klimatike, të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt;

(j)Konsumi i energjisë së pompës në W, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(k)Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë në W, deri në dy shifra dhjetore;

(l)Konsumi vjetor i energjisë elektrike ndihmëse Q_{aux} në kWh për sa i përket energjisë përfundimtare, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

3.2.Një skedë informative e produktit mund të mbulojë një numër modelesh pajisjesh diellore të furnizuara nga i njëjti furnizues.

4. PAKETA E PËRBERË NGA NGROHËS UJI DHE PAJISJE DIELLORE

Skeda informative e produktit e paketave të përbëra nga ngrohës uji dhe pajisje diellore përmban elementet e përcaktuar në Figurën 1 për vlerësimin e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të një pakete të përbërë nga ngrohësi i uji dhe pajisja diellore, ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:

-I: Vlera e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e ngrohësit të ujit, e shprehur në %,

-II: Vlera e shprehjes matematikore $(220 \times Q_{ref})/Q_{nonsol}$, ku Q_{ref} është marrë nga Tabela 3 e Shtojcës VI dhe Q_{nonsol} nga skeda informative e produktit e pajisjes diellore për profilin e deklaruar të ngarkesës M, L, XL ose XXL të ngrohësit të ujit;

-III: Vlera e shprehjes matematikore $(Q_{aux} \cdot 2{,}5) / (220 \cdot Q_{ref})$,$(Q_{aux} \times 2.5)/(220 \times Q_{ref})$ e shprehur në %, ku Q_{aux} është marrë nga skeda e produktit të pajisjes diellore dhe Q_{ref} nga Tabela 3 e Shtojcës VI për profilin e deklaruar të ngarkesës M, L, XL ose XXL.

Figura 1

Skeda informative e produktit e paketës së përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore që tregon efiçencën e energjisë së ngrohjes së ujit të paketës së ofruar



The energy efficiency of the package of products provided for in this fiche may not correspond to its actual energy efficiency once installed in a building, as this efficiency is influenced by further factors such as heat loss in the distribution system and the dimensioning of the products in relation to building size and characteristics.

SHTOJCA IV
Dokumentacioni teknik

1. NGROHËSIT E UJIT

Dokumentacioni teknik i përmendur në Kreun III(1)(c) Për ngrohësit e ujit, përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) Një përshkrim të modelit të ngrohësit të ujit që është i mjaftueshëm për identifikimin e tij të qartë;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(d) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(e) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(f) Rezultatet e matjeve të parametrave teknik të përcaktuar në pikën 7 të Shtojcës VI;

(g) Rezultatet e llogaritjeve të parametrave teknikë të përcaktuar në pikën 2 të Shtojcës VII;

(h) Çdo masë paraprake specifike që merret kur ngrohësi i ujit montohet, instalohet ose mirëmbahet.

2. DEPOZITAT E UJIT TË NGROHTË

Dokumentacioni teknik i përmendur në Kreun III(2)(c) për depozitat e ujit të ngrohtë përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) Një përshkrim të modelit të depozitës së ujit të ngrohtë i mjaftueshëm për identifikimin e qartë të saj;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(d) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(e) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(f) Rezultatet e matjeve të parametrave teknik të përcaktuar në pikën 8 të Shtojcës VI;

(g) Çdo masë paraprake specifike që merret kur depozita e ujit të ngrohtë montohet, instalohet ose mirëmbahet.

3. PAJISJET DIELLORE

Dokumentacioni teknik i pajisjeve diellore të përmendura në Kreun III(3)(b) përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b) Një përshkrim të modelit të pajisjes diellore i mjaftueshëm për identifikimin e qartë të saj;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(d) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(e) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(f) Rezultatet e matjeve të parametrave teknik të përcaktuar në pikën 9 të Shtojcës VI;

(g) Çdo masë paraprake specifike që merret kur pajisja diellore montohet, instalohet ose mirëmbahet.

4. PAKETAT E PËRBËRA NGA NGROHËS UJI DHE PAJISJE DIELLORE

Dokumentacioni teknik i paketave të përbëra nga ngrohësi i ujit dhe të pajisja diellore i përmendur në Kreun III(4)(c) përfshin:

(a) Emrin dhe adresën e furnizuesit;

(b)Një përshkrim të modelit të paketës të përbërë nga ngrohës uji dhe pajisje diellore i mjaftueshëm për identifikimin e qartë të tij;

(c) Referencat e standardeve të harmonizuara të zbatuara, aty ku është e përshtatshme;

(d) Standardet dhe specifikimet e tjera teknike të përdorura, sipas rastit;

(e) Identifikimin dhe nënshkrimin e personit të autorizuar për të angazhuar furnizuesin;

(f) Parametrat teknikë:

-Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt,

- Parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të kësaj shtojce;

(g)Çdo masë paraprake specifike që merret kur montohet, instalohet ose mirëmbahet paketa e ngrohësit të ujit dhe e pajisjes diellore.

SHTOJCA V

Informacioni që duhet të jepet në rastet kur përdoruesit fundorë nuk mund të presin të shohin produktin e shfaqur

1. NGROHËSIT E UJIT

1.1. Informacioni i përmendur në Kreun IV(1)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Profili i deklaruar i ngarkesës, i shprehur me shkronjën përkatëse dhe përdorimi tipik në përputhje me Tabelën 3 të Shtojcës VI;

(b) Klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e modelit, në kushte mesatare klimatike, në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I;

(c) Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, në kushtet mesatare klimatike, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 3 të Shtojcës VII;

(d) Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kËh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma të *GCV*-së, në kushte mesatare klimatike, i rrumbullakosur në numrin më të afërt të plotë dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII;

(e) Niveli i fuqisë së zhurmës, brenda, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, nëse ka);

Përveç kësaj, për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:

(f) Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe e llogaritur në përputhje me pikën 3 të Shtojcës VII;

(g) Konsumi vjetor i energjisë elektrike në kËh në terma të energjisë përfundimtare dhe/ose konsumi vjetor i lëndës djegëse në GJ në terma të *GCV*-së, në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt dhe i llogaritur në përputhje me pikën 4 të Shtojcës VII;

Përveç kësaj, për ngrohësit diellorë të ujit:

(h) Zona e hapjes së kolektorit në m^2, deri në dy shifra dhjetore;

(i) Vëllimi i ruajtjes në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Gjithashtu, për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:

(j) Niveli i fuqisë së zhurmës, jashtë, në dB, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

1.2. Kur jepen edhe informacione të tjera të përfshira në skedën informative të produktit, ato duhet të jenë në formën dhe rendin e specifikuar në pikën 1 të Shtojcës III.

1.3. Madhësia dhe formati i shkronjave, në të cilat shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikat 1.1 dhe 1.2 duhet të jenë të lexueshme.

2. DEPOZITAT E UJIT TË NGROHTË

2.1. Informacioni i përmendur në Kreun IV(2)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) Klasa e efiçencës së energjisë së modelit, e përcaktuar sipas pikës 2 të Shtojcës I;

(b) Konsumi e energjisë për ruajtjen e temperaturës së ujit të ngrohtë në W, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(c) Vëllimi i ruajtjes në litra, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

2.2. Madhësia dhe formati i shkronjave, në të cilat shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikat 2.1, duhet të jenë të lexueshme.

3. PAKETAT E PËRBERA NGA NGROHËS UJI DHE PAJISJE DIELLORE

3.1. Informacioni i përmendur në Kreun IV(3)(b) jepet në rendin e mëposhtëm:

(a) klasa e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit e modelit, e përcaktuar në përputhje me pikën 1 të Shtojcës I;

(b) Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit në %, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

(c) Elementet e përcaktuara në Figurën 1 të Shtojcës III.

3.2. Madhësia dhe formati i shkronjave, në të cilat shkruhet ose tregohet informacioni i përmendur në pikat 3.1, duhet të jenë të lexueshme.

SHTOJCA VI
Matjet dhe metodat e llogaritjes

1. Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur standarde të harmonizuara evropiane të miratuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme të cilat marrin parasysh teknologjinë moderne përgjithësisht të njohur. Ato plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 2 deri në 9.
2. Kushtet e përgjithshme për testimin e ngrohësve të ujit:
(a) Matjet kryhen duke përdorur profilet e ngarkesës të përcaktuara në Tabelën 3;
(b) Matjet kryhen duke përdorur një cikël matjeje 24-orësh si më poshtë:
- 00:00 deri në 06:59: pa shkarkim uji,
- Nga ora 07:00: shkarkim uji sipas profilit të ngarkesës së deklaruar,
-nga përfundimi i shkarkimit të fundit të ujit deri në orën 24:00:pa shkarkim uji;
(c)Profili i ngarkesës së deklaruar është profili i ngarkesës maksimale ose profili i ngarkesës një nën profilin e ngarkesës maksimale.

Tabela 3

Profilet e ngarkesës së ngrohësve të ujit

h	**3XS**			**XXS**			**XS**			**S**			
	Q_{ap}	f	T_m	Q_{ap}	f	T_m	Q_{ap}	f	T_m	Q_{ap}	f	T_m	T_p
	kWh	**l/min**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**
07:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
07:05	**0,015**	2	25										
07:15	**0,015**	2	25										
07:26	**0,015**	2	25										
07:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25	**0,525**	3	35	**0,105**	3	25	

07:45													
08:01													
08:05													
08:15													
08:25													
08:30				**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
08:45													
09:00	**0,015**	2	25										
09:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
ora 10:00													
10:30													
11:00													
11:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
11:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	

12:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
12:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
12:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25	**0,525**	3	35	**0,315**	4	10	55
14:30	**0,015**	2	25										
15:00	**0,015**	2	25										
15:30	**0,015**	2	25										
16:00	**0,015**	2	25										
16:30													
17:00													
ora 18:00				**0,105**	2	25				**0,105**	3	25	
18:15				**0,105**	2	25				**0,105**	3	40	
18:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
19:00	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
19:30	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							

20:00				**0,105**	2	25							
20:30							**1,05**	3	35	**0,42**	4	10	55
20:45				**0,105**	2	25							
20:46													
21:00				**0,105**	2	25							
21:15	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
21:30	**0,015**	2	25							**0,525**	5	45	
21:35	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
21:45	**0,015**	2	25	**0,105**	2	25							
Q_{ref}	0,345			2100			2100			2100			

Vazhdim Tabela 3

Profilet e ngarkesës së ngrohësve të ujit

h	**M**				**L**				**XL**			
	Q_{tap}	f	T_m	T_p	Q_{tap}	f	T_m	T_p	Q_{tap}	f	T_m	T_p
	kWh	**l/min**	**°C**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**	**kWh**	**l/min**	**°C**	**°C**
07:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	

07:05	**1,4**	6	40		**1,4**	6	40					
07:15									**1,82**	6	40	
07:26									**0,105**	3	25	
07:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25					
07:45					**0,105**	3	25		**4,42**	10	10	40
08:01	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
08:05					**3605**	10	10	40				
08:15	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
08:25					**0,105**	3	25					
08:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
08:45	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
09:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
09:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
ora 10:00									**0,105**	3	25	

10:30	**0,105**	3	10	40	**0,105**	3	10	40	**0,105**	3	10	40
11:00									**0,105**	3	25	
11:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
11:45	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
12:00												
12:30												
12:45	**0,315**	4	10	55	**0,315**	4	10	55	**0,735**	4	10	55
14:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
15:00									**0,105**	3	25	
15:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
16:00									**0,105**	3	25	
16:30	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
17:00									**0,105**	3	25	
ora 18:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	

18:15	**0,105**	3	40		**0,105**	3	40		**0,105**	3	40	
18:30	**0,105**	3	40		**0,105**	3	40		**0,105**	3	40	
19:00	**0,105**	3	25		**0,105**	3	25		**0,105**	3	25	
19:30												
20:00												
20:30	**0,735**	4	10	55	**0,735**	4	10	55	**0,735**	4	10	55
20:45												
20:46									**4,42**	10	10	40
21:00					**3605**	10	10	40				
21:15	**0,105**	3	25						**0,105**	3	25	
21:30	**1,4**	6	40		**0,105**	3	25		**4,42**	10	10	40
21:35												
21:45												
Q ref	5845				11655				19,07			

Vazhdim Tabela 3

Profilet e ngarkesës së ngrohësve të ujit

h	XXL			
	Q_{tap}	f	T_m	T_p
	kWh	**l/min**	**°C**	**°C**
07:00	**0,105**	3	25	
07:05				
07:15	**1,82**	6	40	
07:26	**0,105**	3	25	
07:30				
07:45	**6,24**	16	10	40
08:01	**0,105**	3	25	
08:05				
08:15	**0,105**	3	25	
08:25				
08:30	**0,105**	3	25	
08:45	**0,105**	3	25	
09:00	**0,105**	3	25	
09:30	**0,105**	3	25	
ora 10:00	**0,105**	3	25	
10:30	**0,105**	3	10	40
11:00	**0,105**	3	25	
11:30	**0,105**	3	25	
11:45	**0,105**	3	25	

12:00				
12:30				
12:45	**0,735**	4	10	55
14:30	**0,105**	3	25	
15:00	**0,105**	3	25	
15:30	**0,105**	3	25	
16:00	**0,105**	3	25	
16:30	**0,105**	3	25	
17:00	**0,105**	3	25	
ora 18:00	**0,105**	3	25	
18:15	**0,105**	3	40	
18:30	**0,105**	3	40	
ora 19:00	**0,105**	3	25	
19:30				
20:00				
20:30	**0,735**	4	10	55
20:45				
20:46	**6,24**	16	10	40
21:00				
21:15	**0,105**	3	25	
21:30	**6,24**	16	10	40
21:35				

21:45				
Q_{ref}				24,53

3. Kushtet e testimit të përputhshmërisë së kontrollit inteligjent (*smart*) të ngrohësve të ujit

Kur furnizuesi e sheh të përshtatshme të deklarojë vlerën *smart* si "1", matjet e konsumit javor të energjisë elektrike dhe/ose të lëndës djegëse me kontrolle inteligjente dhe të konsumit javor të energjisë elektrike dhe/ose lëndës djegëse pa kontrolle inteligjente realizohen duke përdorur ciklin dy-javor të matjes si më poshtë:

-Ditët 1 deri në 5: radha e rastësishme e profileve të ngarkesës e zgjedhur nga profili i deklaruar i ngarkesës dhe profili i ngarkesës një nën profilin e deklaruar të ngarkesës dhe kontrolli inteligjent i çaktivizuar,

-Ditët 6 dhe 7: nuk ka shkarkim uji dhe kontrolli inteligjent është i çaktivizuar,

-Ditët 8 deri në 12: përsëritja e së njëjtës radhë që është aplikuar për ditët 1 deri në 5 dhe kontrolli inteligjent i aktivizuar,

-Ditët 13 dhe 14: nuk ka shkarkim uji dhe kontrolli inteligjent është aktivizuar,

-Diferenca midis përmbajtjes së energjisë së dobishme të matur gjatë ditëve 1 deri në 7 dhe përmbajtjes së energjisë së dobishme të matur gjatë ditëve 8 deri në 14 nuk duhet të kalojë 2 % të Q_{ref} të profilit të ngarkesës së deklaruar.

4. Kushtet për testimin e ngrohësve diellorë të ujit

Kolektori diellor, depozita e ujit të ngrohtë diellor, pompa në unazën e kolektorit (nëse përdoret) dhe prodhuesi i nxehtësisë testohen veçmas. Kur kolektori diellor dhe depozita e ujit të ngrohtë diellor nuk mund të testohen veçmas, ato testohen në kombinim. Prodhuesi i nxehtësisë testohet sipas kushteve të përcaktuara në pikën 2 të kësaj shtojce.

Rezultatet përdoren për llogaritjet e përcaktuara në pikën 3(b) të Shtojcës VII sipas kushteve të përcaktuara në Tabelat 4 dhe 5. Për qëllimin e përcaktimit të Q_{totat} efiçenca e prodhuesit të nxehtësisë duke përdorur efektin Xhaul në elementët e ngrohjes me rezistencë elektrike supozohet të jetë 100/ CC , e shprehur në %.

5. Kushtet e testimit të ngrohësve të ujit me pompë nxehtësie

-Ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie testohen sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 6,

-Ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie që përdorin ajrin që shkarkohet nga ventilimi si burim ngrohtësie testohen sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 7.

6. Kushtet e testimit të pajisjeve diellore

Kolektori diellor, depozita e ujit të ngrohtë diellor dhe pompa në unazën e kolektorit (nëse përdoret) testohen veçmas. Kur kolektori diellor dhe depozita e ujit të ngrohtë diellor nuk mund të testohen veçmas, ato testohen në kombinim.

Rezultatet përdoren për llogaritjet e Q_{nonsol} për profilet e ngarkesës M, L, XL dhe XXL nën kushtet mesatare klimatike të përcaktuara në Tabelat 4 dhe 5 dhe Q_{aux}.

Tabela 4

Temperatura mesatare e ditës [°C]

	janar	**shkurt**	**mars**	**prill**	**maj**	**qershor**	**korrik**	**gusht**	**shtator**	**tetor**	**Nëntor**	**dhjetor**
Kushtet mesatare klimatike	+2,8	+2,6	+7,4	+12,2	+16,3	+19,8	+21,0	+22,0	+17,0	+11,9	+5,6	+3,2
Kushtet klimatike më të ftohta	-3,8	-4,1	–0,6	+5,2	+11,0	+16,5	+19,3	+18,4	+12,8	+6,7	+1,2	–3,5
Kushtet klimatike më të ngrohta	+9,5	+10,1	+11,6	+15,3	+21,4	+26,5	+28,8	+27,9	+23,6	+19,0	+14,5	+10,4

Tabela 5

Rrezatimi mesatar global diellor [W/m ^{2}]

	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	Nëntor	dhjetor
Kushtet mesatare klimatike	70	104	149	192	221	222	232	217	176	129	80	56
Kushtet klimatike më të ftohta	22	75	124	192	234	237	238	181	120	64	23	13
Kushtet klimatike më të ngrohta	128	137	182	227	248	268	268	263	243	175	126	109

Tabela 6

Kushtet standarde të vlerësimit të ngrohësve të ujit me pompë nxehtësie, temperaturat e ajrit të thatë të mjedisit (temperatura e ajrit të lagësht të mjedisit në kllapa)

Burimi i nxehtësisë	**Ajri i jashtëm**	**Ajri i brendshëm**	**Ajri i shkarkimit**	**Lagështira**	**Uji**

Kushtet klimatike	Kushtet mesatare klimatike	Kushtet klimatike më të ftohta	Kushtet klimatike më të ngrohta	E pazbatueshme	Të gjitha kushtet klimatike		
Temperatura	+ 7 °C (+ 6 °C)	+ 2 °C (+ 1 °C)	+ 14 °C (+ 13 °C)	+ 20 °C (maksimumi + 15 °C)	+ 20 °C (+ 12 °C)	0 °C (hyrje)/– 3 °C (dalje)	+ 10 °C (hyrje)/+ 7 °C (dalje)

Tabela 7

Shkarkimi maksimal i disponueshëm i ajrit të ventilimit [m^3/h], në një temperaturë prej 20 °C dhe me lagështi 5,5 g/m^3

Profili i ngarkesës së deklaruar	XXS	XS	S	M	L	XL	XXL
Shkarkimi maksimal i disponueshëm i ajrit të ventilimit	109	128	128	159	190	870	1 021

7. Parametrat teknik të ngrohësve të ujit

Për ngrohësit e ujit vendosen parametrat e mëposhtëm:

(a) Konsumi ditor i energjisë elektrike Q_{elec} në kWh, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(b) Profili i deklaruar i ngarkesës, i shprehur me shkronjën përkatëse në përputhje me Tabelën 3 të kësaj shtojce;

(c) Niveli i fuqisë së zhurmës në dB, brenda, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt (për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie, nëse ka);

Përveç kësaj, për ngrohësit e ujit që përdorin lëndë djegëse fosile dhe/ose biomasë:

(d) Konsumi ditor i lëndës djegëse Q_{fuel} në kWh në terma të *GCV*-së, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

Përveç kësaj, për ngrohësit e ujit për të cilët vlera smart është deklaruar si "1":

(e) Konsumi javor i lëndës djegëse me kontrolle inteligjente $Q_{fuel,ëeek,smart}$ në kWh në terma të *GCV*-së, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(f) Konsumi javor i energjisë elektrike me kontrolle inteligjente $Q_{elec,ëeek,smart}$ në kWh, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(g)Konsumi javor i lëndës djegëset pa kontrolle inteligjente $Q_{fuel,ëeek}$ në kWh në terma të GCV-së, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(h)Konsumi javor i energjisë elektrike pa kontrolle inteligjente $Q_{elec,ëeek}$ në kWh, i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

Përveç kësaj, për ngrohësit diellorë të ujit:

(i) Zona e hapjes së kolektorit A_{sol} në m^2, e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(j) Efiçenca me zero humbje η_0, e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(k) Koefiçienti i rendit të parë a_1 në W /(m^2 K), i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(l) Koefiçienti i rendit të dytë a_2 në W/(m^2 K^2), i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(m) Modifikuesi i këndit të incidencës *IAM*, i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(n) Konsumi i energjisë së pompës *solpump* në W, i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(o)Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë *solstandby* në W, i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

Përveç kësaj, për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:

(p)Niveli i fuqisë së zhurmës L_{WA} në dB, jashtë, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt.

8. Parametrat teknik të depozitave të ujit të ngrohtë

Për depozitat e ujit të ngrohtë vendosen parametrat e mëposhtëm:

(a) Vëllimi i ruajtjes V në litra, i rrumbullakosur në një numër dhjetor;

(b) Humbjet termike S në W, të rrumbullakosura në një numër dhjetor.

9. Parametrat teknikë të pajisjeve diellore

Për pajisjet diellore vendosen parametrat e mëposhtëm:

(a) Zona e hapjes së kolektorit A_{sol} në m^2, e rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(b) Efiçenca me zero humbje η_0, e rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(c) Koefiçienti i rendit të parë a_1 në W /(m^2 K), i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(d) Koefiçienti i rendit të dytë a_2 në W/(m^2 K^2), i rrumbullakosur në tre shifra dhjetore;

(e) Modifikuesi i këndit të incidencës *IAM* , i rrumbullakosur në dy vende dhjetore ;

(f) Konsumi i energjisë së pompës *solpompa* në W, i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore;

(g)Konsumi i energjisë në modalitetin e gatishmërisë, *solstandby* në W, i rrumbullakosur në dy shifra dhjetore.

SHTOJCA VII

Metoda për llogaritjen e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit të ngrohësve të ujit

1 Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të respektimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, matjet dhe llogaritjet kryhen sipas standardeve të harmonizuara evropiane të miratuara, ose metoda të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme të cilat marrin parasysh teknologjinë moderne

përgjithësisht të njohur.Ato plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë të përcaktuar në pikat 2 deri në 6.
Parametrat teknikë të përdorur për llogaritjet maten në përputhje me Shtojcën VI.

2. Parametrat teknikë të ngrohësve të ujit

Për ngrohësit e ujit në kushte mesatare klimatike llogariten parametrat e mëposhtëm:
(a)Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit η_{wh} në %, e rrumbullakosur në një numër dhjetor;
(b)Konsumi vjetor i energjisë elektrike AEC në kWh në terma të energjisë përfundimtare, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
Përveç kësaj, për ngrohësit e ujit që përdorin lëndë djegëse në kushte mesatare klimatike:
(c)Konsumi vjetor i lëndës djegëse AFC në kWh në terma të GCV-së, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
Gjithashtu, për ngrohësit diellorë të ujit në kushte mesatare klimatike:
(d)Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit e prodhuesit të nxehtësisë $\eta_{wh,nonsol}$ në %, e rrumbullakosur në një numër dhjetor;
(e)Konsumi vjetor i energjisë elektrike ndihmëse Q_{aux} në kWh në terma të energjisë përfundimtare, i rrumbullakosur në një numër dhjetor;
Përveç kësaj, për ngrohësit diellorë të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie në kushte klimatike më të ftohta dhe më të ngrohta:
(f) Parametrat e përcaktuar në pikat (a) deri (c);
Gjithashtu, për ngrohësit diellorë të ujit në kushte klimatike mesatare, më të ftohta dhe më të ngrohta :
(g)Kontributi vjetor i nxehtësisë jo diellore Q_{nonsol} në kWh në terma të energjisë parësore për energjinë elektrike dhe/ose në kWh në terma të GCV-së për lëndët djegëse, i rrumbullakosur në një shifër dhjetore.

3. Llogaritja e efiçencës së energjisë së ngrohjes së ujit η_{wh}

(a)Ngrohësit e zakonshëm të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:
Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit llogaritet si më poshtë:

$$\eta_{wh} = \frac{Q_{ref}}{(Q_{fuel} + CC \cdot Q_{elec})(1 - SCF \cdot smart) + Q_{cor}}$$

Për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie që ngrohin ujë/ujë të kripur-në-ujë, merret parasysh konsumi i energjisë elektrike i një ose më shumë pompave të ujit nëntokësor.
(b) Ngrohësit diellor të ujit:
Efiçenca e energjisë së ngrohjes së ujit llogaritet si më poshtë:

$$\eta_{wh} = \frac{0{,}6 \cdot 366 \cdot Q_{ref}}{Q_{tota}}$$

Ku:

$$Q_{tota} = \frac{Q_{nonsol}}{1{,}1 \cdot \eta_{wh,nonsol} - 0{,}1} + Q_{aux} \cdot CC$$

4. Llogaritja e konsumit vjetor të energjisë elektrike AEC dhe e konsumit vjetor të lëndës djegëse AFC

(a)Ngrohësit e zakonshëm të ujit dhe ngrohësit e ujit me pompë nxehtësi:

Konsumi vjetor i energjisë elektrike *AEC* në kWh në terma të energjisë përfundimtare llogaritet si më poshtë:

$$AEC = 0{,}6 \cdot 366 \cdot \left(Q_{elec} \cdot (1 - SCF \cdot smart) + \frac{Q_{cor}}{CC} \right)$$

Konsumi vjetor i lëndës djegëse *AFC* në GJ në terma të *GCV*-së llogaritet si më poshtë:

AFC=0.6x366x(Q_{fuel} x (1-SCFxsmart)+Q_{cor})

(b)Ngrohësit diellor të ujit:

Konsumi vjetor i energjisë elektrike *AEC* në kËh në terma të energjisë përfundimtare llogaritet si më poshtë:

$$AEC = \frac{CC \cdot Q_{elec}}{Q_{fuel} + CC \cdot Q_{elec}} \cdot \frac{Q_{tota}}{CC}$$

Konsumi vjetor i lëndë djegëset *AFC* në GJ në terma të *GCV*-së llogaritet si më poshtë:

$$AFC = \frac{Q_{fuel}}{Q_{fuel} + CC \cdot Q_{elec}} \cdot Q_{tota}$$

5. Përcaktimi i faktorit të kontrollit inteligjent *SCF* dhe i pajtueshmërisë me kontrollin *inteligjent*

(a) Faktori i kontrollit inteligjent llogaritet si më poshtë:

$$SCF = 1 - \frac{Q_{fuel,week,smart} + CC \cdot Q_{elec,week,smart}}{Q_{fuel,week} + CC \cdot Q_{elec,week}}$$

(b)Nëse $SCF \geq 0{,}07$, vlera e *smart* është 1. Në të gjitha rastet e tjera, vlera e *smart* është 0.

6. Përcaktimi i termit të korrigjimit të mjedisit Q_{cor}

Afati i korrigjimit të mjedisit llogaritet si më poshtë:

(a) Për ngrohësit e zakonshëm të ujit që përdorin energji elektrike:

$$Q_{cor} = -k \text{ x } (CC \text{ x } (1\text{-}SCF \text{ x } smart) - Q_{ref}$$

(b) Për ngrohësit zakonshëm të ujit që përdorin lëndë djegëse:

$$Q_{cor} = -k \times (Q_{fuel} \times (1-SCF \times smart) - Q_{ref}$$

(c) Për ngrohësit e ujit me pompë nxehtësie:

$$Q_{cor} = -k \times 24h \times P_{stby}$$

Ku:

Vlerat-k janë dhënë në Tabelën 8 për çdo profil ngarkese.

Tabela 8

k-vlerat

	3XS	**XXS**	**XS**	**S**	**M**	**L**	**XL**	**XXL**
k	0,23	0,23	0,23	0,23	0,23	0,23	0,23	0,0

SHTOJCA VIII

Procedura e kontrollit të konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

Tolerancat e verifikimit të përcaktuara në këtë Shtojcë lidhen vetëm me verifikimin nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut të vlerave të deklaruara dhe nuk duhet të përdoren nga furnizuesi si tolerancë e lejuar për të përcaktuar vlerat në dokumentacionin teknik ose për të interpretuar këto vlera me synimin e arritjes së përputhshmërisë ose për të komunikuar performancë më të mirë. Vlerat dhe klasat e publikuara në etiketë ose në skedën e informacionit të produktit nuk duhet të jenë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara në dokumentacionin teknik.

Gjatë verifikimit të përputhshmërisë së një modeli produkti me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore të Deleguar, për kërkesat e referuara në këtë Shtojcë, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton procedurën e mëposhtme:

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston një njësi të vetme për model.
2. Modeli konsiderohet se respekton kërkesat e aplikueshme:

(a) Vlerat e dhëna në dokumentacionin teknik sipas pikës 3 të nenit 9 të Ligjit 52/2024, dhe, sipas rastit, vlerat e përdorura për llogaritjen e këtyre vlerave, nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat përkatëse të dhëna në raportet e testimit; dhe

(b) Vlerat e publikuara në etiketë dhe në fletën e informacionit të produktit nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa vlerat e deklaruara, dhe klasa e treguar e eficencës së energjisë nuk janë më të favorshme për furnizuesin sesa klasa e përcaktuar nga vlerat e deklaruara; dhe

(c) Kur Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut teston njësinë e modelit, vlerat e përcaktuara (vlerat e parametrave përkatës të matura në testim dhe vlerat e llogaritura nga këto matje) përputhen me tolerancat përkatëse të verifikimit siç janë dhënë në Tabelën 9.

3. Nëse rezultatet e përmendura në pikat 2 (a) ose (b) nuk arrihen, modeli dhe të gjitha modelet ekuivalente konsiderohen se nuk respektojnë këtë rregullore.
4. Nëse rezultati i përmendur në pikën 2(c) nuk arrihet, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zgjedh tre njësi shtesë të së njëjtit model për testim. Si alternativë, tre njësitë shtesë të zgjedhura mund t'i përkasin një ose më shumë modeleve të ndryshme, të cilat janë renditur si produkt i barasvlershëm në dokumentacionin teknik të furnizuesit.
5. Modeli konsiderohet se respekton kërkesat e zbatueshme nëse për këto tre njësi mesatarja aritmetike e vlerave të përcaktuara përputhet me tolerancat përkatëse të dhëna në Tabelën 9.
6. Nëse rezultati i përmendur në pikën 5 nuk arrihet, modeli dhe të gjitha modelet e barasvlershme konsiderohen se nuk janë sipas kësaj rregulloreje.
7. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut jep të gjithë informacionin përkatës pa vonesë, pasi të merret një vendim për mosrespektimin e kërkesave nga ana e modelit sipas pikave 3 dhe 6 të kësaj Shtojce.

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përdor metodat e matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në Shtojcën VI dhe VII.
Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut zbaton vetëm tolerancat e verifikimit të përcaktuara në Tabelën 9 dhe përdor vetëm procedurën e përshkruar në pikat 1 deri në 7 për kërkesat e referuara në këtë Shtojcë. Nuk lejohet zbatimi i asnjë tolerance tjetër, përfshirë ato të përcaktuara në standarde të harmonizuara apo në ndonjë metodë tjetër matjeje.

Tabela 9

Tolerancat e verifikimit

Parametri i matur	**Toleranca e verifikimit**
Konsumi ditor i energjisë elektrike Q_{elec}	Vlera e matur nuk është më e lartë se 5% krahasuar me vlerën e deklaruar ([1]) .
